

# Vlerësim i themelimit, funktionalizimit dhe performancës së mekanizmave komunalë të pjesëmarrjes dhe përfaqësimit të komuniteteve

Tetor 2021



Organizata për Siguri dhe  
Bashkëpunim në Evropë  
Misioni në Kosovë



**Vlerësim i themelimit,  
funktionalizimit dhe  
performancës së mekanizmave  
komunalë të pjesëmarrjes dhe  
përfaqësimit të komuniteteve**

Tetor 2021

# PËRMBAJTJA

<b>1. PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE</b>	<b>5</b>
<b>2. HYRJE</b>	<b>7</b>
<b>3. VËSHTRIM I KORNIZËS LIGJORE DHE TË POLITIKAVE</b>	<b>9</b>
<b>4. PËRMBLEDHJE E GJETJEVE</b>	<b>10</b>
<b>5. KOMITETI PËR KOMUNITETE</b>	<b>12</b>
a. Korniza ligjore	12
b. Korniza e politikave	14
c. Vlerësim	16
d. Përmbledhje e gjetjeve	19
<b>6. ZYRA KOMUNALE PËR KOMUNITETE DHE KTHIM</b>	<b>21</b>
a. Korniza ligjore	21
b. Korniza e politikave	23
c. Vlerësim	24
d. Përmbledhje e gjetjeve	27
<b>7. NËNKRYETARI PËR KOMUNITETE</b>	<b>29</b>
a. Korniza ligjore	29
b. Korniza e politikave	30
c. Vlerësim	32
d. Përmbledhje e gjetjeve	36
<b>8. ZËVENDËSKRYESUESI I KUVENDIT TË KOMUNËS PËR KOMUNITETE</b>	<b>37</b>
a. Korniza ligjore	37
b. Korniza e politikave	38
c. Vlerësim	39
d. Përmbledhje e gjetjeve	42
<b>9. ANALIZA GJINORE</b>	<b>43</b>
<b>10. KONSTATIME</b>	<b>47</b>
<b>11. REKOMANDIME</b>	<b>49</b>
<b>12. SHTOJCA - MEKANIZMAT SIPAS KOMUNËS</b>	<b>53</b>

## LISTA E SHKURTESAVE

<b>UA</b>	Udhëzim administrativ
<b>KK</b>	Komiteti për Komunitete
<b>ZK K K K</b>	Zëvendëskryesuesi i Kuvendit të Komunës për Komunitete
<b>N K K K</b>	Nënkryetari i Komunës për Komunitete
<b>LVQL</b>	Ligji për vetëqeverisjen lokale
<b>KK</b>	Kuvendi i komunës
<b>MKK</b>	Ministria për Komunitete dhe Kthim
<b>MAPL</b>	Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal
<b>ZK K K</b>	Zyra Komunale për Komunitete dhe Kthim
<b>OSBE</b>	Organizata për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë
<b>OMiK</b>	Misioni në Kosovë i Organizatës për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë
<b>TeR</b>	Termet e referencës

## PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE

Ky raport ofron informacion të hollësishëm lidhur me kornizat ligjore dhe të politikave, si dhe mbi krijimin, funksionimin dhe përbërjen e mekanizmave komunalë që e kanë detyrë mbrojtjen dhe promovimin e të drejtave dhe interesave të komuniteteve joshumicë në Kosovë. Këto mekanizma, komiteti i komuniteteve (KK), zyra komunale për komunitete dhe kthim (ZKKK), nënkryetari i komunës për komunitete (NKKK) dhe zëvendëskryesuesi i kuvendit komunal për komunitete (ZKKKK), u krijuan veç e veç një dekadë e më shumë para se të shkruhej ky raport dhe nuk kanë qenë objekt i raporteve tematike të Misionit të OSBE-së në Kosovë (OSBE) që nga viti 2014. Prandaj, ky raport shërben si përditësim për të vlerësuar zhvillimin e këtyre mekanizmave që nga viti 2014, ndërsa për mekanizmat e KK-së dhe ZKKKK-së vlerëson punën e tyre nga fundi i mandatit të pushtetit lokal në 2017 deri në fund të vitit 2019, përmes analizës krahasuese të të dhënave.

Në përgjithësi, këta mekanizma kanë shënuar përparim të ngadaltë por gradual në arritjen e potencialit të tyre të plotë, me përparim shkallëzor në realizimin e detyrave themelore siç janë përcaktuar nga legjislacioni përkatës. Në mënyrë të ngjashme, ndonëse është hartuar legjislacioni i ri i rëndësishëm për transparencën dhe konsultimin publik në komuna, është bërë përparim i kufizuar në hartimin e legjislacionit dytësor për të siguruar caktimin e detyrave themelore e të qarta për mekanizmat e vlerësuar në këtë raport. Megjithatë, përparimi në zhvillimin e këtyre mekanizmave ka treguar se ata janë të aftë të ndikojnë pozitivisht në komunitetet në mbarë Kosovën dhe, në pothuajse çdo rast, janë themeluar aty ku ka qenë e nevojshme. Aty ku këta mekanizma janë fuqizuar në mënyrë adekuate dhe kanë marrë iniciativë për të vepruar, avokimi dhe veprimet e drejtpërdrejta të këtyre mekanizmave kanë kontribuar në përmirësimin e jetës së komuniteteve dhe marrëdhëniet ndërmjet komuniteteve.

Raporti bën thirrje për qartësi përmes prezantimit të legjislacionit dytësor të ri që ndihmon në rrumbullakimin e detyrave themelore dhe standardeve të qarta të performancës për mekanizmat e vlerësuar. Për NKKK-në dhe ZKKKK-në, është e domosdoshme që të vihet theks më i madh në trajtimin e rasteve ku këto role janë krijuar në mjedise ku nuk janë të detyrueshme, duke zhvilluar njëherazi një rol alternativ për komunat për t'i promovuar komunitetet e që ruan edhe karakterin unik kushtetues dhe ligjor të këtyre mekanizmave. Vendet e paplotësuara në këto pozita, ku janë të detyrueshme, mbeten goxha shqetësim.

Sa u përket vetë komunave, ne e theksojmë rëndësinë e një qasjeje të përfshirjes mbarëkomunale, ku kryetari i komunës dhe drejtuesit e lartë komunalë marrin më shumë pronësi mbi funksionalitetin e mekanizmave të pjesëmarrjes së komunitetit dhe promovojnë zhvillimin e tyre. Angazhimi më i madh proaktiv nga mekanizmat dhe nëpërmjet strukturave komunale me komunitetet do të ndihmojë në këtë drejtim.

Përfundimisht, ndërkohë që mekanizmat në fjalë vazhdojnë zhvillimin gradual, energjia e rinovuar dhe përpjekjet që pikësynim kanë përshpejtimin e rritjes pozitive dhe korigjimin e mangësive mbeten të rëndësishme për mbrojtjen e komuniteteve dhe për pjesëmarrjen e tyre të plotë në jetën politike në Kosovë.

## HYRJE

Komunat janë nyje kritike të qeverisjes dhe janë jetike për shumëetninë në Kosovë, siç parashihet në Kushtetutë.<sup>1</sup> Në shërbim të këtij qëllimi, në komuna janë krijuar katër mekanizma kryesorë për të promovuar dhe mbrojtur të drejtat dhe interesat e komuniteteve në nivelin komunal. Secilit prej këtyre mekanizmave të renditur më poshtë i kushtohet një kapitull në këtë raport që shpjegon bazën e tyre të plotë ligjore dhe të politikave si dhe vlerësimet e performancës së tyre.

**Komitetet për komunitete (KK) përbëhen nga përfaqësues të komuniteteve që jetojnë në komunë dhe anëtarë të kuvendeve komunale. Themelimi i tyre është i detyrueshëm. Mandati kryesor i KK-së është të shqyrtojë të gjitha politikat, praktikat dhe aktivitetet komunale me qëllim të rekomandimit të masave për kuvendet komunale për të siguruar respektimin e të drejtave dhe interesave të komuniteteve.**

**Zyrat komunale për komunitete dhe kthim (ZKKK) përbëhen nga nëpunës civilë dhe janë të detyrueshme për të gjitha komunat. Mandati kryesor i ZKKK-së është të mbrojnë të drejtat e komuniteteve, të sigurojnë qasje të barabartë në shërbime dhe të krijojnë kushte për realizimin e kthimit të qëndrueshëm.**

**Nënkryetarët e komunave për komunitete (NKKK) janë të detyrueshëm në komuna ku komunitetet në pakicë numerike përbëjnë të paktën dhjetë për qind të popullsisë së komunës. Mandati i NKKK-së është të ofrojë këshilla dhe udhëzime për kryetarin e komunës për çështje që lidhen me të gjitha komunitetet që banojnë në komunë.**

**Zëvendëskryesuesit e kuvendeve komunale për komunitete (ZKKKK) janë gjithashtu të detyrueshëm në komunat ku komunitetet në pakicë numerike përbëjnë së paku dhjetë për qind të popullsisë së komunës. Mandati kryesor i ZKKKK-së është të sigurojë që të drejtat e komuniteteve të mos cenohen dhe të shërbejë si një pikë kontakti për komunitetet brenda kuvendit të komunës.**

Meqë shumë prej këtyre mekanizmave u krijuan pak para mandatit 2013-2017 të pushtetit komunal, ky raport do të vlerësojë përparimin e këtyre mekanizmave dhe të bëjë vlerësimin e parë gjithëpërfshirës të OSBE-së për këta mekanizma që nga raporti "Vlerësim i mekanizmave të nivelit lokal për mbrojtjen dhe promovimin e të drejtave dhe interesave të komuniteteve në Kosovë" i vitit 2014.<sup>2</sup> Në përgjithësi, vlerësimet e këtyre mekanizmave krahasojnë performancën e tyre në periudhën mes fundit të mandatit të qeverisë komunale 2017 dhe fundit të vitit 2019.

---

<sup>1</sup> Kushtetuta e Kosovës, 9 prill 2008.

<sup>2</sup> Raport i OSBE-së "Vlerësim i mekanizmave të nivelit lokal për mbrojtjen dhe promovimin e të drejtave dhe interesave të komuniteteve në Kosovë" (qershor 2014) <https://www.osce.org/kosovo/120343?download=true>



## Metodologjia

Çdo vit, Misioni i OSBE-së në Kosovë interviston përfaqësues nga secili mekanizëm në që të 38 komunat e Kosovës me anë të një sërë pyetjesh lidhur me themelimin, përbërjen dhe performancën e tyre. Pyetjet bazohen në aspekte specifike të kornizës ligjore ose të politikave që kanë të bëjnë me secilin nga mekanizmat e vlerësuar. Përgjigjet për këto pyetje, të dhëna nga përfaqësuesit e lartpërmendur, së bashku me vëzhgimet nga monitorimi i ekipeve në terren të OSBE-së, përbëjnë bazën e të dhënave në këtë raport. Këto të dhëna, së bashku me pyetjet specifike nga pyetësi i përvitshëm, do të paraqiten në kapitujt gjegjësisht kushtuar mekanizmave specifike të këtij raporti. Në mënyrë të ngjashme, në secilin kapitull kushtuar mekanizmit specifik do të paraqitet një shqyrtim i kornizave ligjore dhe të politikave për secilin mekanizëm. Për sa u përket mekanizmave KK dhe ZKKK, aty ku është e mundur këto të dhëna do të jenë të natyrës krahasuese. Të dhënat e paraqitura në këto segmente do t'i shfaqin të dhënat e mbledhura në fund të vitit 2019 dhe do të tregojnë në ç' masë komunat kanë përmbushur detyrimin e tyre ligjor ose të politikave krahasuar me tetorin e vitit 2017. Krahasimi me tetorin 2017 është bërë duke qenë se përfaqëson fundin e mandatit qeverisës komunal, që vazhdoi midis 1 janarit 2014 dhe 22 tetorit 2017 dhe rrjedhimisht siguroi kohë të mjaftueshme për zhvillimin e këtyre mekanizmave. Këto të dhëna krahasohen me vitin 2019 pasi këta mekanizma kishin dy vjet kohë në mandatin e tyre të ri për t'u njoftuar me dhe për t'i përmbushur detyrimet e tyre. Megjithatë nuk krahasohet me periudhën 2017, mekanizmat ZKKK dhe NKKKK gjithashtu pasqyrohen me të dhënat e tyre të vitit 2019 dhe analizën shoqëruese të kornizave të tyre ligjore dhe mënyrën se si janë duke i përmbushur detyrat e tyre.

Raporti shqyrton kornizën ligjore dhe të politikave që prekë të gjithë mekanizmat me një vështrim, jep një përmbledhje të gjetjeve nga të dhënat e mbledhura, paraqet gjetjet specifike për secilin mekanizëm, si dhe i përshkruan në hollësi ligjet, politikat dhe të dhënat për secilin mekanizëm, vlerëson të dhënat për secilin, dhe në fund, përmbillet me rekomandime për qeverinë dhe institucionet komunale.

## VËSHTRIM I KORNIZËS LIGJORE DHE TË POLITIKAVE

Kushtetuta<sup>3</sup> e përkufizon Kosovën si shoqëri shumëetnike e përbërë nga shqiptarë dhe komunitete të tjera. Nga neni 3 e tutje, komunitetet vazhdojnë të përmenden e paraqiten në mënyrë të dukshme në Kushtetutë, veçanërisht në nenin 22, i cili ndër të tjera pohon afirmon zbatueshmërinë e drejtpërdrejtë të Paktit Ndërkombëtar për të Drejtat Civile dhe Politike dhe të Konventës Kornizë për Mbrojtjen e Pakicave Kombëtare (Konventa Kornizë).<sup>4</sup> Në Raportin shpjegues të Konventës Kornizë, kjo përcaktohet më tej si pjesëmarrje e pakicave në të gjitha aspektet e institucioneve qeverisëse në të gjitha nivelet dhe në format e qeverisjes së decentralizuar ose lokale.<sup>5</sup> Krahas kësaj, i një rëndësie të veçantë për qeverisjen lokale në Kosovë është neni 15 i Konventës Kornizë, i cili kërkon krijimin e kushteve të nevojshme për pjesëmarrjen efektive të komuniteteve pakicë në jetën kulturore, shoqërore dhe ekonomike dhe në çështjet publike.<sup>6</sup> Këto dokumente të marra së bashku përbëjnë bazën më të lartë ligjore për mbrojtjen dhe pjesëmarrjen e komuniteteve joshumicë në Kosovë.

Ligji për vetëqeverisjen lokale<sup>7</sup> (LVQL) rregullon kompetencat që u janë bartur dhe strukturën ekzekutive të komunave dhe, *mesh tjerash*, përcakton KK-në, NKK-në dhe ZKKKK-në, ku ky i fundit parashihet po ashtu drejtpërdrejt në nenin 62 të Kushtetutës nën titullin origjinal si Zëvendëskryetar për komunitete i kuvendit të komunës.<sup>8</sup> Ligji për mbrojtjen dhe promovimin e të drejtave të komuniteteve dhe pjesëtarëve të tyre<sup>9</sup> i afirmon më tej parimet kushtetuese të pjesëmarrjes dhe përfaqësimit të komuniteteve joshumicë në vendimmarrje, përfshirë përmes krijimit të posteve të NKK-së dhe ZKKKK-së. Për qëllime të këtij raporti, janë hulumtuar vetëm këto ligje dhe legjislacioni ndihmës subsidiar pasi ato përfaqësojnë kornizën ligjore më përkatëse të mekanizmave të vlerësuar. Si i tillë, legjislacioni dytësor i LVQL-së është veçanërisht i rëndësishëm për KK-në, i cili përcaktohet si një nga dy komitetet e përhershme të detyrueshme për secilën komunë, gjersa ZKKK-ja përcaktohet në një akt nënligjor të LVQL-së e jo në vetë ligjin. Aktet nënligjore që janë marrë në konsideratë në këtë vlerësim janë hulumtuar në hollësi në secilin kapitull kushtuar mekanizmit specifik. E vetmja pjesë tjetër e legjislacionit e konsideruar në këtë raport është Ligji për barazinë gjinore<sup>10</sup> meqë edhe ashtu diskutohet në masë të kufizuar në LVQL ose aktet përkatëse të tij nënligjore.

---

<sup>3</sup> Kushtetuta e Kosovës, shënimi i mësipërm 1.

<sup>4</sup> Raport shpjegues i Konventës Kornizë për Mbrojtjen e Pakicave Kombëtare, (1995) <https://rm.coe.int/16800cb5eb>.

<sup>5</sup> Po aty.

<sup>6</sup> Po aty.

<sup>7</sup> Ligji Nr. 03/L - 040 për vetëqeverisjen lokale (4 qershor 2008).

<sup>8</sup> Kushtetuta, shënimi i mësipërm 1.

<sup>9</sup> Ligji nr. 03/L-047 për mbrojtjen dhe promovimin e të drejtave të komuniteteve dhe pjesëtarëve të tyre (4 qershor 2008), ndryshuar me Ligjin nr. 04/L - 020 të 27 dhjetorit 2011 dhe Ligjin nr. 04/L-115 (7 shtator 2012)

<sup>10</sup> Ligji nr. 05/L-20 për barazi gjinore (26 qershor 2015).

In addition to this legal framework, the Ministry of Local Government Administration (MLGA) has also developed Terms of Reference (ToRs) for the CC, MOCR, DMC, and DCMAC. The ToRs provide more detailed guidance for each mechanism to give further detail on substantive tasks for each mechanism such as reporting timeframes, methods of conducting outreach, and on numerous other categories in order to provide comprehensive standard operating procedures. While these ToRs are not legally binding, they are important to guiding the establishment, performance and functionality of these mechanisms as the legislation is often broad and vague in its stipulations. Details of these ToRs and guidelines are also explored in greater detail in each mechanism-specific chapter.

## PËRMBLEDHJE E GJETJEVE

Më shumë se një dekadë pas krijimit të tyre, mekanizmat për mbrojtjen dhe pjesëmarrjen e komuniteteve kanë shfaqur përgjithësisht përparim të ngadaltë por gradual drejt përmbushjes së detyrimeve ligjore dhe të kornizës së politikave. Sidoqoftë, vazhdon të ketë akoma sfida në krijimin, performancën dhe funksionalitetin e tyre, si dhe me kornizat ligjore dhe të politikave në suazat e të cilave janë krijuar për të punuar këta mekanizma.

- Me një përjashtim të pjesshëm të ZKKK-së, korniza ligjore që rregullon këta mekanizma vazhdon të ketë përgjithësisht mungesë të përcaktimit, veçanërisht për sa u përket standardeve të qarta të performancës dhe detyrave themelore siç janë takimet dhe raportimi. Të gjithë mekanizmat e vlerësuar në këtë raport shfaqën një hendek shumë të gjerë midis disa detyrave themelore me përkufizim të kufizuar në kornizën ligjore dhe një varg detyrash më të fuqishme në kornizën e politikave. Përkufizimi i pamjaftueshëm i detyrave dhe kërkesave për këta mekanizma, dhe mungesa e kushteve dhe udhëzimeve për komponentët e tjerë të ekzekutivit komunal dhe kuvendit të komunës për të punuar me këta mekanizma, pengon gjithashtu integrimin e tyre si komponentë thelbësorë të vendimmarrjes komunale.
- Në mbarë Kosovën, mekanizmat që janë vlerësuar zakonisht i përmbushin detyrat themelore ligjore të detyrueshme të parapara me kornizat e tyre përkatëse ligjore, megjithatë ato shpesh nuk performojnë në nivelin e përcaktuar nga korniza e politikave për të njëjtat detyra. Mbyllja e hendekut midis zbatimit të detyrave të parapara me kornizën ligjore dhe përcaktimit të plotë të këtyre detyrave në kornizën e politikave mbetet e rëndësishme.
- Krahas nevojës për një qartësi më të madhe ligjore, shembujt praktikë dhe metodat e zbatimit mund të pasurojnë më tej atë çfarë është tashmë e paraparë me kornizën e politikave. Korniza aktuale e politikave parasheh detyra themelore që u ndihmojnë këtyre mekanizmave në mungesë të udhëzimeve ose rregulloreve të qarta administrative,

megjithatë ajo nuk është një udhëzues zbatimi. Kjo është veçanërisht e rëndësishme për detyrat më pak të definuara që nuk kanë një rezultat të qartë siç është promovimi i dialogut ose shërbimi si një pikë qendrore kontakti. Modelet e raportimit dhe udhëzimet e zbatimit ekzistojnë për KK-të dhe janë të dobishme, megjithatë këto udhëzime mund të zgjerohen dhe modelet mund të përpilohen edhe për detyra të tjera të rëndësishme si zhvillimi i projektit për ZKKK-të.

- NKK-të dhe ZKKKK-të kanë dëshmuar aftësinë e tyre për të qenë mbrojtës të arsyeshëm efektivë për komunitetet ku ata janë themeluar, qoftë në komunat ku pozitat e tyre janë të apo në ato ku nuk është janë të detyrueshme. Duke pasur parasysh paqartësinë ekzistuese në lidhje me prapësinë prej dhjetë për qind, në veçanti për ZKKKK-në, është e nevojshme të përcaktohet një rrugë e qartë ligjore për themelimin e këtij mekanizmi, si dhe trysni për ta themeluar këtë mekanizëm dhe NKK-në në situatat kur është i detyrueshëm por nuk është themeluar.
- Kërkesat lidhur me përbërjen dhe përzgjedhjen janë më se të nevojshme për mekanizmat e KK, NKK dhe ZKKKK pasi ato kanë të bëjnë me përkatësinë e komunitetit. Çështja se cilat komunitete duhet të përfaqësohen në KK, ose cili komunitet duhet përfaqësuar në mekanizmat e NKK ose ZKKKK mund të ndërlikohet nga mosbesueshmëria e statistikave për numrin e popullsisë. Në mënyrë të ngjashme, për NKK-në dhe ZKKKK-në, kriteret për të vlerësuar se në cilat komuna dhjetë për qind e popullsisë përbëhet nga komunitetet joshumicë janë gjithashtu të paqarta. Regjistrimi i përditësuar i popullsisë do të ishte një masë veçanërisht e dobishme në këtë drejtim.
- Përkitazi me progresin në përfaqësimin gjinor, një i tillë është vërejtur në lidhje me KK-të, por është i papërfillshëm në mesin e mekanizmave të tjerë. Respektimi i Ligjit për barazi gjinore<sup>11</sup> nga ana e komunave mbetet problematik, qoftë sa i përket përfaqësimit të përgjithshëm të grave ashtu edhe për nga natyra se si ato përfaqësohen brenda vetë komunave, meqë progresi i kufizuar që ka ndodhur nuk është realizuar në mënyrë të barabartë në të gjithë mekanizmat mbarë Kosovës.

---

<sup>11</sup> Po aty.

## KOMITETI PËR KOMUNITETE

### ▪ KORNIZA LIGJORE

KK përkufizohet nga LVQL si një nga dy komitetet e përhershme në secilën komunë së bashku me Komitetin për Politikë dhe Financa.<sup>12</sup> Sipas nenit 53.1, KK-ve duhet që në radhët e veta të përfshijnë anëtarë të kuvendit të komunës dhe përfaqësues të komuniteteve. Veç kësaj, neni parasheh që çdo komunitet që banon në komunë të përfaqësohet nga të paktën një përfaqësues në KK. Në nenin 53.2, KK-ve u kërkohet që të shqyrtojnë pajtueshmërinë e autoriteteve komunale me ligjin në fuqi, të shqyrtojnë të gjitha politikat, praktikat dhe aktivitetet komunale për t'u siguruar se të drejtat dhe interesat e komuniteteve respektohen plotësisht, të rekomandojnë masa për të promovuar shprehjen dhe trashëgiminë e komuniteteve, si dhe të sigurojnë mbrojtjen e tyre adekuate në komunë. Këto dispozita formojnë bazën më të rëndësishme ligjore për përbërjen dhe përgjegjësitë e këtyre mekanizmave. Përgjegjësitë më të hollësishme dhe kërkesat lidhur me përbërjen specifikohen në aktet nënligjore të LVQL-së.

Ashtu si të gjithë mekanizmat e shqyrtuar në këtë raport, KK i nënshtrohet akteve nënligjore të LVQL-së në formën e rregulloreve dhe udhëzimeve administrative. Derisa shumë prej këtyre udhëzimeve dhe rregulloreve administrative ofrojnë kërkesa të përgjithshme për funksionimin dhe administrimin e KK-së si komitet i përhershëm<sup>13</sup>, vetëm tre sosh japin udhëzime të drejtpërdrejta dhe specifike mbi përbërjen dhe përgjegjësitë e KK.<sup>14</sup> Këto akte nënligjore janë të rëndësishme për përcaktimin e përbërjes dhe kriterëve të përzgjedhjes për këtë mekanizëm, si dhe përgjegjësitë dhe kompetencat e tij precize. Këto diskutohen më gjerësisht në segmentet vijuese, ku dispozitat specifike të këtyre akteve nënligjore janë paraqitur në tabelën a.

### **Përbërja dhe kriteret e përzgjedhjes sipas akteve nënligjore**

*Udhëzimi administrativ nr. 03/2014 për procedurën e themelimit, përbërjen dhe kompetencat e komiteteve të përhershme në komuna - i plotësuar dhe ndryshuar me Udhëzimin administrativ nr. 02/2018 (nxjerrë më 22 tetor 2018).*

- Në nenin 7 të plotësimeve dhe ndryshimeve të vitit 2018 thuhet se KK përbëhet nga pesë deri në shtatë anëtarë dhe, në komunat ku nuk ka komunitete joshumicë, KK

<sup>12</sup> Neni 53, Ligji nr. 03/L – 040 për vetëqeverisjen lokale, (4 qershor 2008).

<sup>13</sup> UA (MAPL) nr. 2010/01 për kufizimin e kompensimit dhe marrjes së pagesës nga zyrtarët e komunave (10 mars 2010), UA nr. 03/2020 për transparencën në komuna (25 shtator 2020), UA nr. 06/2018 për standardet minimale të konsultimit publik në komuna (31 dhjetor 2018).

<sup>14</sup> UA nr. 2011/02 për përcaktimin e procedurave për zbatimin e Ligjit për përdorimin e gjuhëve (4 prill 2011), UA nr. 03/2014 për procedurën e themelimit, përbërjen dhe kompetencat e komiteteve të përhershme në komuna dhe plotësimet e ndryshimet e tij me UA nr. 02/2018 (22 nëntor 2018), Rregullorja 01/2017 për procedurën e hartimit dhe publikimin e akteve të komunës (23 gusht 2017).

mund të përbëhet nga komunitete të tjera e që nuk janë saktësuar në udhëzimin në fjalë.

- Për sa i përket zgjedhjes së anëtarëve të KK-së, udhëzimi thotë se kjo do të bëhet me propozimin e kandidatëve nga komuniteti joshumicë në komunë, ndërsa kuvendi i komunës i miraton këta kandidatë. Kryesuesi i KK-së zgjidhet me shumicën e votave të anëtarëve të KK ose, në mungesë të kryesuesit, mbledhjen e KK-së e kryeson anëtari më i vjetër për nga mosha. Së fundi, KK duhet gjithashtu të përfshijë anëtarë të komuniteteve joshumicë që nuk janë të përfaqësuara në kuvendin e komunës.

**Përgjegjësitë dhe kompetencat e drejtpërdrejta të KK-ve sipas akteve nënligjore (tabela a)**

<b><i>UA nr. 2011/02 për përcaktimin e procedurave për zbatimin e Ligjit për përdorimin e gjuhëve</i></b>	<b><i>Rregullorja nr. 01/2017 për procedurën e hartimit dhe publikimin e akteve të komunës</i></b>	<b><i>UA nr. 03/2014 për procedurën e themelimit, përbërjen dhe kompetencat e komiteteve të përhershme në komuna - e plotësuar dhe ndryshuar me UA nr. 02/2018</i></b>
<p>Neni 4 përvijon procedurën për njohjen e gjuhëve të folura tradicionalisht në një komunë. Në këtë drejtim, KK përmendet në mënyrë të qartë në nenin 4.4 si një organ i kërkuar për të shqyrtuar kërkesat e komunitetit për të përfshirë një gjuhë të folur tradicionalisht, ku më pas i paraqet rekomandim kuvendit të komunës.</p>	<p>Neni 13 i kësaj rregulloreje identifikon se cilat organe të një komune mund të propozojnë akte normative komunale. Siç përcaktohet me këtë rregullore, komitetet e kuvendit të komunës kanë mundësi të propozojnë legjislacion, pra KK si një komitet i detyrueshëm i përhershëm ka mundësinë që të propozojë legjislacion.</p>	<p>Neni 8 në mënyrë efektive i ripohon përgjegjësitë e KK-së në nenin 53 të LVQL-së, por nuk jep ndonjë hollësi shtesë se si duhen realizuar këto detyra.</p> <p>Neni 11 mbi rekomandimet dhe raportimin në komitetet e përhershme përcakton që, si komitet i përhershëm, KK-të duhet të paraqesë raport vjetor për punën e tyre në kuvendin komunal për miratim.</p>

## **Udhëzimi administrativ nr. 05/2020 për procedurën e themelimit, përbërjen dhe kompetencat e komiteteve të përhershme dhe komiteteve tjera në komunë<sup>15</sup>**

Ky udhëzim administrativ, i datës 21 dhjetor 2020, është planifikuar të hyjë në fuqi pas zgjedhjeve lokale të vitit 2021 dhe, si i tillë, nuk është pjesë e kornizës ligjore të vlerësuar në këtë raport. Sidoqoftë, ky udhëzim është i rëndësishëm për zhvillimin e këtij mekaniizmi dhe do të shfuqizojë dhe zëvendësojë udhëzimet e mëparshme administrative të vitit 2014 dhe 2018 me të njëjtin emër të cilat diskutohen në segmentet e këtij kapitulli për përbërjen dhe përgjegjësinë e drejtpërdrejtë. Meqë ka të bëjë me përbërjen dhe zgjedhjen e anëtarëve të KK, ky udhëzim bën një ndryshim të rëndësishëm pasi sqaron se në përbërjen e tij duhet të jetë nga një anëtar i secilit komunitet joshumicë që jeton në komunë, pa vendosur ndonjë numër fiks të anëtarëve. Ky është një zhvillim pozitiv ngaqë sipas udhëzimit të mëhershëm disa komuna e kishin tejkuluar maksimumin prej shtatë përfaqësuesve pasi kishin më shumë se shtatë komunitete joshumicë. Udhëzimi sqaron gjithashtu se në komunat ku nuk ka komunitete joshumicë, KK mund të përbëhet nga anëtarë të shoqërisë civile ose komunitetit të biznesit, megjithëse nuk duhet të ketë më shumë se pesë anëtarë në këto raste. Aspekti i përbërjes së paraparë me ligj gjithashtu është avancuar në kuptimin e përbërjes gjinore, pasi përmendet në mënyrë të qartë që përbërja e komitetit duhet të pasqyrojnë barazinë gjinore.

Lidhur me detyrat dhe përgjegjësitë e drejtpërdrejta, pak ka ndryshuar nga udhëzimet e vitit 2014 dhe 2018 për këtë komitet. I vetmi ndryshim i dukshëm është se raportet vjetore të KK-së për vitin paraprak duhet të dorëzohen në kuvend komunal jo më vonë se në fund të marsit të çdo viti.

### ▪ **KORNIZA E POLITIKAVE**

TeR për KK, hartuar nga MAPL në vitin 2012, u krijuan për t'i ofruar KK-ve një përshkrim të standardizuar të përgjegjësive që përçojnë fushëveprimin e plotë të detyrave dhe përgjegjësive të tyre, si dhe procedurat që rregullojnë krijimin dhe funksionimin e tyre.<sup>16</sup> Në mënyrë të dukshme, TeR-ja forcon më tutje kriteret për përbërjen dhe përzgjedhjen e anëtarëve të KK-së duke i bërë gjithashtu pjesëtarët e Policisë së Kosovës ose Forcës së Sigurisë së Kosovës, gjyqtarët dhe prokurorët, nëpunësit civilë ose ata që janë pjesë e ekzekutivit komunal, ose atyre që u është hequr aftësia juridike me vendim të gjykatës, si të papërshtatshëm për një pozitë në KK. TeR shtjellon gjithashtu procedurat e përzgjedhjes së kryesuesit dhe zëvendëskryesuesit të komitetit. Për më tepër, ndryshe nga përshkrimet relativisht të gjera të legjislacionit përkatës, TeR kërkon që KK-të të ndërmarrin detyra të shumta substanciale që nuk paraqiten në LVQL.

<sup>15</sup> UA nr. 05/2020 për procedurën e themelimit, përbërjen dhe kompetencat e komiteteve të përhershme dhe komiteteve të tjera në komunë (21 dhjetor 2020)

<sup>16</sup> Ky dokument nuk gjendet në internet.

**Detyrat kryesore themelore të përcaktuara me TeR që nuk janë trajtuar në LVQL (tabela b)**

<b>Shqyrtimi i legjislacionit komunal</b>	<b>Shqyrtimi i të gjitha praktikave, politikave dhe aktiviteteve komunale</b>	<b>Paraqitja e legjislacionit dhe mbledhjes e KK</b>
<p>Ofron udhëzime për organet komunale mbi kornizën ligjore dhe institucionale për mbrojtjen e të drejtave të komuniteteve.</p>	<p>Rishikon projektbuxhetin vjetor të komunës dhe avokon për përfshirjen e mjeteve dhe fondeve për aktivitetet që synojnë promovimin e të drejtave të komuniteteve.</p>	<p>Formulon dhe diskuton rekomandimet me kryetarin, kuvendin komunal dhe komitetet e tij si dhe drejtoritë komunale.</p>
<p>Shqyrton dhe përcjellë respektimin e formave, procedurave dhe kushteve për përfshirjen dhe pjesëmarrjen e të gjitha komuniteteve në proces vendimmarrjeje dhe planifikimi, si dhe siguron që rekomandimet e KK-së zbatohen.</p>	<p>Rritë kapacitetet e autoriteteve komunale për të arritur tek komunitetet dhe për t'iu përgjigjur nevojave të tyre.</p>	<p>Çdo akt, plan, strategji dhe buxhet vjetor komunal i propozuar i paraqitet komitetit në fazën fillestare.</p>
<p>Raporton të paktën dy herë në vit në kuvendin e komunës dhe tek kryetari i komunës për veprimet, aktivitetet dhe rekomandimet e KK-së.</p>	<p>Siguron që komuniteteve t'u mundësohet t'i shprehin nevojat e tyre dhe që të njëjtat të përfshihen në planet e reagimit/veprimit nëse ka interes që kjo të bëhet për komunitetet.</p>	<p>Rekomandimet e bëra nga komiteti të përfshihen në materialin që u dorëzohet anëtarëve të kuvendit të komunës.</p>
<p>Monitoron zbatimin e rekomandimeve të nxjerra.</p>	<p>Monitoron dhe i raporton në baza të rregullta kuvendit të komunës për zbatimin e projekteve për komunitetet dhe këshillon/konsulton ZKKK-në dhe, nëse është e nevojshme, kryetarin e komunës për zbatimin e projekteve të tilla nëse kërkohet.</p>	<p>Nëse rekomandimet e komitetit nuk përfshihen në rregulloren e propozuar komunale nga kuvendi i komunës brenda dy javësh, KK kërkon arsyetim me shkrim nga kuvendi.</p>
	<p>Konsultohet me ZKKK-në për zgjedhjen e projekteve me prioritet për komunitetet.</p>	<p>Komiteti duhet të mbledhet të paktën një herë në muaj.</p> <p>Kreu i ZKKK-së informon komitetin për raportin e tij të punës tremujore, të kryer nga ajo zyrë.</p>




Derisa shumë dispozita të tjera i ripohojnë ose i pasurojnë me detaje të pjesshme përgjegjësitë ekzistuese, këto detyra kornizë të politikave përfaqësojnë ato më të rëndësishmet për KK-në sa i përket raportimit, takimeve dhe detyrave themelore përveç atyre që janë paraparë tashmë në kornizën ligjore. KK ka në dispozicion po ashtu udhëzime të zbatimit dhe praktika më të mira të hartuara nga MAPL-ja, që janë përpiluar në Udhëzuesin e vitit 2012 për Komitetet e Komuniteteve.<sup>17</sup> Këto formojnë një bazë veçanërisht të dobishme për të zbatuar praktikisht angazhimet legjislative dhe të kornizës së politikave dhe ofrojnë modele specifike për njoftimet publike, planet e punës dhe të ngjashme.

## ■ VLERËSIM I KOMITETIT PËR KOMUNITETE

Vlerësimi i komitetit të komuniteteve bazohet në vëzhgimet e ekipeve në terren të Misionit të OSBE-së në Kosovë dhe pyetësorit të tij vjetor për komunat ku respondentë janë përfaqësuesit e KK-së. Pyetjet e mëposhtme u zgjodhën nga ajo anketë për të ilustruar se si komunat po i përmbushin zotimet e tyre ligjore dhe nga korniza e politikave, dhe për të treguar se si këta mekanizma janë themeluar, funksionalizuar dhe si performojnë në tërë Kosovën. Figurat grafike shfaqin të dhëna nga viti 2019, kurse treguesi, aty ku është dhënë, tregon ndryshimin se sa komuna janë duke i përmbushur zotimin e tyre në krahasim me vitin 2017. Rritjet tregojnë se më shumë KK të komunave po i përmbushin zotimet e tyre në krahasim me 2017, kurse uljet tregojnë se më pak KK të komunave janë duke i përmbushur zotimet e tyre. Emrat e saktë të komunave që përmbushin ose nuk përmbushin zotimet për secilën pyetje në këtë segment mund të gjenden në aneksin e këtij raporti, mekanizmat sipas komunës, përveç nëse përcaktohet ndryshe.

### **A është themeluar siç duhet Komiteti për Komunitete në përputhje me legjislacionin/ rregulloren/rezultatet e regjistrimit të popullsisë në vitin 2011?<sup>18</sup> (19 Po, 19 Jo – treguesi -1)**

Komitetet për komunitete janë themeluar në që të 38 komunat e Kosovës. Gjersa ky mekanizëm ka qenë i vënë në zbatim në të gjitha komunat në vitin 2017 dhe 2019, LVQL-ja thotë se të gjitha komunitetet që banojnë në komunë duhet të përfaqësohen në KK. Përkundër kërkesës, nuk ka ndonjë kusht se sa i madh duhet të jetë komuniteti që përfaqësimi i tij të jetë i detyrueshëm, dhe as se si konfirmohet që të gjitha komunitetet janë të përfaqësuar. Megjithëse nuk përmendet qartë në kornizën ligjore, për qëllimet e këtij raporti përdoret regjistrimi i popullsisë i vitit 2011<sup>19</sup>. Mirëpo, meqë regjistrimi i popullsisë nuk



<sup>17</sup> Udhëzues për Komitetin për Komunitete, (2012), ky dokument nuk gjendet në internet.


<sup>18</sup> Ligji nr. 03/L - 040 për vetëqeverisjen lokale, (4 qershor 2008).

<sup>19</sup> Raporti i regjistrimit të popullsisë të vitit 2011 gjendet në: <https://ask.rks-gov.net/en/kosovo-agency-of-statistics/social/population-and-housing-census>

ishite mbajtur në komunat e Leposaviqit, Mitrovicës Veriore, Zubin Potokut dhe Zveçanit, ato vlerësohen në këtë raport sipas vlerësimeve të numrit të popullsisë nga radhët e komuniteteve të marra nga publikimi i OSBE-së “Profilet e komunave” të vitit 2018.<sup>20</sup> Kështu, është e rëndësishme të theksohet se sipas një interpretimi strikt KK i përfaqëson të gjitha komunitetet bazuar në regjistrimin e vitit 2011 pavarësisht nga madhësia e tyre në regjistrim. Në vitin 2019, 19 komuna e përmbushën këtë objektiv.


### **A është hartuar dhe aprovuar ndonjë plan pune apo plan aktiviteti për KK? <sup>21</sup> (28 Po, 10 Jo, treguesi +1)**

Megjithëse planet e punës nuk janë pjesë e kornizës legislative të KK-së ose TeR së saj, shumica e komunave e kanë përfshirë këtë praktikë të mirë që buron nga udhëzimet e KK-së. Në këtë drejtim, një rritje marginale prej një komune përbën përparim të kufizuar, por megjithatë pozitiv, të vazhdimit të formalizimit dhe rregullimit të KK si mekanizëm që zhvillon aktivitete. Gjithashtu, kjo dëshmon një nivel vullneti të shumicës së KK-ve për të bërë më shumë se sa kërkesat themelore ligjore.



### **A ka raportuar KK çdo gjashtë muaj në kuvendin e komunës për punën e vet?<sup>22</sup> (3 Po, 35 Jo, treguesi -6)**

Sipas ligjit, kërkesa e vetme për raportim për KK-në është t’i dorëzojë një raport vjetor me shkrim kuvendit të komunës. Në kornizën e politikave (tabela b), megjithatë, përcaktohet që KK t’i raportojë për punën e vet kuvendit dy herë në vit, pa specifikuar nëse ky raportim duhet bërë me shkrim ose me gojë. Monitorimi në terren i OSBE-së ka vënë re se në shumë komuna, anëtarët e kuvendit të komunës të cilët janë njëherësh dhe anëtarë të KK-së raportojnë joformalisht mbi aktivitetet e KK-së gjatë seancave të kuvendit, megjithatë kjo bëhet mbi baza ad hoc. Pavarësisht nga forma me gojë apo me shkrim, realizimi i kërkesës për raportim në kornizën e politikave sipas së cilës KK duhet të raportojë zyrtarisht në kuvendin e komunës ka treguar një rënie të ndjeshme midis 2017 dhe 2019.




<sup>20</sup> Raport i OSBE-së, *Përmbledhje e të gjitha profileve të komunave 2018*, (29 janar 2019), <https://www.osce.org/mission-in-kosovo/410279?download=true>.

<sup>21</sup> Udhëzimet për Komitetin për Komunitete, (2012), ky dokument nuk gjendet në internet.

<sup>22</sup> Termat e referencës për Komitetin për Komunitete (2012), ky dokument nuk gjendet në internet ndonjë detyrat kryesore themelore të përcaktuara me këtë dokument mund të gjenden në tabelën b të këtij raporti


### A ka nxjerrë KK-ja raport vjetor me shkrim? Nëse jo, a ka ndonjë plan/zotim specifik për të raportuar?<sup>23</sup> (14 Po, 24 Jo, treguesi +6)

Dorëzimi i raportit vjetor me shkrim për aprovim nga kuvendi i komunës është i vetmi rezultat që kërkohet ligjërisht nga komiteti. Kornizat ligjore dhe të politikave e trajtojnë këtë obligim; megjithatë, nuk parashihen afatet e dorëzimit<sup>24</sup> dhe kështu, përgjigjet me "po" në këtë segment fillojnë të llogariten nga koha kur nxirret një draft i raportit vjetor me shkrim, ose nga koha kur pritet të dalë së shpejti. Me këto kritere, raportet vjetore me shkrim ishin dorëzuar ose ishin në hartim e sipër në më pak se gjysmën e komunave të vlerësuara, edhe pse ishte rezultati i vetëm formal i shkruar që duhej dorëzuar. Sidoqoftë, përparimi ka qenë i konsiderueshëm që nga viti 2017, ku gjashtë KK të tjera nxorën raport vjetor të shkruar në vitin 2019 krahasuar me vitin 2017, si dhe disa KK të tjera që deklaruan synimin e tyre për ta hartuar raportin me shkrim në vitin 2020.



### A ka nxjerrë KK rekomandime për organet komunale për çështje specifike lidhur me mbrojtjen/promovimin e të drejtave të komuniteteve?<sup>25</sup> (23 Po, 15 Jo, treguesi +6)

Në kontekstin e zotimeve në kornizën e politikave, KK-të në gjithë Kosovën kanë shënuar përmirësime të konsiderueshme në lidhje me dhënien e rekomandimeve për çështje specifike në lidhje me komunitetet. Në vitin 2019, shembujt e ca prej rekomandimeve të bëra nga KK-të përfshinin mes tjerash ndarjen e parcelave për familjet e kthyera që nuk kishin pronë (Ferizaj), rritjen e përfshirjes së komunitetit në procesin e buxhetit komunal (Vushtrri), mbështetjen enkas të komuniteteve romë të Kosovës dhe ashkali të Kosovës përmes rekomandimit të përmirësimeve në ujësjellës dhe kanalizim (Klinë) si dhe ndarjes së parcelave për varreza për shfrytëzim nga komuniteti rom dhe ai serb i Kosovës (Graçanicë, Shtime). Ndërsa ka pasur rritje të konsiderueshme nga 17 në 23 të komunave që kishin nxjerrë rekomandime,



<sup>23</sup> UA nr. 03/2014 për procedurën e themelimit, përbërjen dhe kompetencat e komiteteve të përhershme në komuna, i plotësuar dhe ndryshuar me UA nr. 02/2018 (22 nëntor 2018).


<sup>24</sup> Kjo i referohet kornizës ligjore gjatë periudhës kohore të këtij raporti. Siç diskutohet në segmentin për UA nr. 05/2020 për procedurën e themelimit, përbërjen dhe kompetencat e komiteteve të përhershme dhe komiteteve të tjera në komunë, kjo do të ndryshojë pas zgjedhjeve lokale në vitin 2021.

<sup>25</sup> Termat e referencës për Komitetin për Komunitete (2012), ky dokument nuk gjendet në internet ndonëse detyrat kryesore themelore të përcaktuara me këtë dokument mund të gjenden në tabelën b të këtij raporti.

vazhdon të ketë ndryshueshmëri të madhe sa i përket numrit të rekomandimeve. Derisa disa KK ishin shumë aktive në dhënien e rekomandimeve, numri i rekomandimeve të dhëna nga secila komunë nuk ishte i njëjtë, pasi disa nxjerrin pak, ndërsa KK tjera nxjerrin më shumë të tillë.

**A ka shqyrtuar KK politikat, praktikat dhe aktivitetet komunale për të siguruar respektimin e plotë të të drejtave dhe interesave të komuniteteve?<sup>26</sup> (17 Po, 21 Jo, treguesi +2)**

Ngjashëm me përmirësimin e ndjeshëm të shkallës së përmbushjes së kërkesës për dhënien e rekomandimeve specifike për të drejtat e komuniteteve midis periudhave të raportimit, kërkesa ligjore që KK-të të shqyrtojnë të gjitha politikat, praktikat dhe aktivitetet komunale ka shënuar rritje modeste, ndonëse pse në vitin 2019 numri i komunave në pajtueshmëri të plotë akoma mbetet pak më pak se gjysma. Kjo është detyrë themelore veçanërisht e rëndësishme, ngaqë përmes kësaj dispozite KK përfshihet në procesin e vendimmarrjes së një komune. Duke pasur parasysh fushëveprimin e gjerë të mandatit shqyrtues të të gjitha politikave, praktikave dhe aktiviteteve, këtu hyn edhe buxheti i komunës. Megjithëse neni 53.2 i LVQL-së përmend "të gjitha" politikat, praktikat dhe aktivitetet komunale, në praktikë pothuajse asnjë KK nuk arrin në këtë nivel shqyrtimi. Prandaj, përgjigjet "po" në këtë pyetje konsiderohen si të atilla që kanë bërë çfarëdo niveli të shqyrtimit të politikave, aktiviteteve ose praktikave. Ekipet e OSBE-së në terren përgjithësisht vërejnë që ato KK që angazhohen në forma të caktuara të shqyrtimit të politikave, aktiviteteve dhe praktikave, përgjithësisht shqyrtojnë në mesatare të përafërt prej 50 për qind deri nën 80 për qind të dokumenteve të tilla.



**▪ PËRMBLEDHJE E GJETJEVE - KOMITETI PËR KOMUNITETE**

- Ndërsa KK përkufizohet me ligj si komiteti i vetëm i përhershëm përveç Komitetit për Politikë dhe Financa, në praktikë KK-të nuk janë integruar në mënyrë të barabartë në infrastrukturën vendimmarrëse të komunave në tërë Kosovën.
- KK-të kanë shënuar përgjithësisht progres pozitiv në përmbushjen e kërkesave minimale të parapara me kornizën ligjore dhe të politikave. Sidoqoftë, kur vlerësohet se si këto organe shqyrtojnë të gjitha aktivitetet e komunës ose ndjekin ciklin e plotë të zbatimit të rekomandimeve të dhëna, shumica e KK-ve nuk përmbushin të gjitha synimet e kornizës

<sup>26</sup> Neni 53, Ligji nr. 03/L-040 për vetëqeverisjen lokale (4 qershor 2008).

së politikave ose detyrat tjera themelore më strikte dhe të hollësishme të parapara me kornizën e politikave (tabela b).

- Megjithëse aktet e shumta ligjore e përkufizojnë KK përgjithësisht si komitetet të përhershëm, korniza e politikave ofron një gamë të gjerë të standardeve dhe kriterëve plotësuese të performancës që duhen përbushur. Kriteret siç janë kërkesat për raportim, kriteri i mbledhjeve të detyrueshme dhe planet e punës mund të ngrihen në nivel të kornizës ligjore, pasi KK-ve aktualisht iu mungojnë rezultate përmbajtjesore të përcaktuara me ligj.
- KK-të janë themeluar dhe janë aktive në të gjithë Kosovën. Sidoqoftë, ato shfaqin një shkallë të gjerë të ndryshueshmërisë në kuptimin e funksionimit apo të përbushjes së detyrave të tyre. Detyrimi për të raportuar në kuvendin e komunës e dëshmon këtë mungesë të procedurës zyrtare, ndërsa nxjerra e rekomandimeve ilustron nivelin e ndryshueshëm të aktivitetit të ndërmarrë nga këto komitete, kur ata përbushin angazhimet e tyre lidhur me kornizën ligjore dhe atë të politikave.
- Detyrimi i KK-së për të shqyrtuar të gjitha politikat dhe aktivitetet komunale është një prej detyrave të tij më të rëndësishme themelore. Sidoqoftë, korniza ligjore dhe ajo e politikave në lidhje me këtë detyrim janë të paqarta, ndërsa kjo është një fushë e punës së KK që kërkon përmirësim. Përshkrimi në nivelin e kornizës ligjore, në nenin 53.2 të LVQL-së, duhet të përfshijë efektivisht shqyrtimin e gjithë asaj që miratohet në kuvendin e komunës, megjithatë korniza e politikave (tabela b) specifikon që buxheti duhet të dorëzohet fillimisht në KK për shqyrtim. Ndërsa KK është ligjërisht përgjegjës për shqyrtimin dhe komentimin e buxhetit në kontekstin e shqyrtimit të aktiviteteve, procedurat për standardizimin e tij si mekanizëm i detyrueshëm i shqyrtimit mund të përforcohen.
- KK-të në mbarë Kosovën kanë demonstruar se kur janë të formalizuara dhe të fuqizuara siç duhet, mund të jenë vegla të çmueshme për ndërmarrjen e veprimeve konkrete dhe për të sjellë ndryshime domethënëse në komunat ku ata veprojnë. Miratimi në shkallë të gjerë i planeve të punës të parapara me kornizën e politikave dhe rekomandimet gjithnjë e më të gjerësishme dhe të hollësishme për administratën komunale kanë treguar përparim të dukshëm. Këto janë masa të cilat duhet të nxiten. Megjithatë, rënia e konsiderueshme e shkallës së raportimit gjashtëmujor mbetet shqetësim.
- Ndërsa LVQL specifikon që çdo komunitet duhet të përfaqësohet në KK, baza për këtë ndërlikohet nga mungesa e të dhënave të qarta mbi atë se kush banon brenda një komune të caktuar, pjesërisht për shkak të paqëndrueshmërisë së gjerë të të dhënave aktuale për numrin e popullsisë.

## ZYRA KOMUNALE PËR KOMUNITETE DHE KTHIM

### ▪ KORNIZA LIGJORE

Zyra Komunale për Komunitete dhe Kthim (ZKKK) është mekanizëm unik për mbrojtjen e komuniteteve. Ndryshe nga mekanizmat e tjerë të vlerësuar në këtë raport, kjo është zyrë me personel të përhershëm dhe nuk u nënshtrohet kërkesave specifike për përbërje apo përzgjedhje jashtë rregullave të përgjithshme për shërbimin civil. Gjithashtu, ndryshe nga mekanizmat e tjerë në këtë raport, ZKKK-ja nuk është e paraparë me vetë LVQL-në, por në fakt ajo i merr përgjegjësitë e saj themelore për sa u përket komuniteteve nga një akt nënligjor i LVQL-së, Rregullorja për zyrat komunale për komunitete dhe kthim.<sup>27</sup>

Rregullorja nr. 02/2010 e përcakton mekanizmin dhe i jep mandat të dyfishtë për identifikimin, zbatimin dhe monitorimin e politikave, aktiviteteve dhe programeve në lidhje me mbrojtjen dhe promovimin e të drejtave të komuniteteve dhe për mbështetjen e të gjithë të kthyerve, refugjatëve dhe personave të zhvendosur brenda vendit. Ky vlerësim analizon vetëm mandatin dhe funksionet e saj për sa u përket komuniteteve në përgjithësi, jo funksioneve të saj të lidhura me zhvendosjen.

### **Kërkesat për personel sipas Rregullores nr. 02/2010**

Në nenet 1, 3, 5 dhe 6 të Rregullores nr. 02/2010 parashihet se ndërsa ZKKK-ja është e detyrueshme për të gjitha komunat, kërkesat për personel kanë elemente të cilat në të njëjtën kohë janë edhe të fiksuara, edhe fleksibël. Neni 5 parasheh se pesë pozita janë të detyrueshme për ZKKK-në, gjegjësisht shefi i zyrës, një koordinator për të drejtat dhe integrimin e komuniteteve, një zyrtar për të drejtat dhe integrimin e komuniteteve, një koordinator për kthim të qëndrueshëm dhe një zyrtar për kthim të qëndrueshëm. Neni 5, lexuar së bashku me nenin 6, parasheh procedurën e vlerësimit se çfarë personeli nevojitet, ku thuhet që kryetari i komunës duhet të udhëzohet sipas kriterëve si numri dhe madhësia e komuniteteve joshumicë, vendndodhja gjeografike e komuniteteve, shkalla e integritit dhe e izolimit të komuniteteve, nevojat specifike të komuniteteve joshumicë, ndryshimet demografike dhe nevoja për të krijuar nënzyra nëse është e nevojshme. Kryetari i komunës më pas kërkon nga Komiteti për Komunitete dhe Komiteti për Politikë dhe Financa i komunës gjegjëse që të japin rekomandime sa i përket numrit të pozitave, gjë që pastaj duhet të miratohet nga Ministria e Financave dhe Transfereve, Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal dhe Ministria për Komunitete dhe Kthim. Bazuar në këtë proces, kryetari i komunës mund të nxjerrë vendim që parasheh numrin e pozitave dhe zyrtarëve që do të veprojnë në komunë.

---

<sup>27</sup> Rregullorja nr. 02/2010 për zyrat komunale për komunitete dhe kthim, (12 gusht 2010).

**Përgjegjësitë dhe kompetencat e drejtpërdrejta sipas Rregullores nr. 02/2010(tabela c)**

<b>Bashkëpunimi</b>	<b>Detyrat dhe përgjegjësitë</b>	<b>Personeli dhe ndarja e detyrave</b>	<b>Bashkëpunimi ndërkomunal</b>
<p>Neni 4 përshkruan bashkëpunimin e detyrueshëm me NKK-në, drejtoritë komunale, ZKKKK-në dhe KK-në. Ky nen parasheh gjithashtu që të gjitha zyrat e komunës janë të detyruara të bashkëpunojnë me ZKKK-në ose të përballen me qortime, siç parashihet me legjislacionin për shërbimin civil.</p>	<p>Neni 7 përcakton në mënyrë të hollësishme detyrat dhe përgjegjësitë më themelore të zyrës, përfshirë promovimin dhe mbrojtjen e të drejtave të komuniteteve dhe pjesëtarëve të tyre si dhe qasjen e tyre të barabartë në shërbimet publike, identifikimin e nevojave parësore të komuniteteve joshumicë dhe zhvillimin, sigurimin dhe monitorimin e projekteve për avancimin e të drejtave të komuniteteve, bashkërendimin ndërmjet institucioneve qeveritare dhe dorëzimin e raporteve të rregullta tek kryetari i komunës, kuvendi i komunës dhe institucionet qeveritare për përparimin e bërë. ZKKK-ja po ashtu duhet të mbajë bazë të të dhënave për qëllime statistikore dhe të politikave për komunitetet joshumicë.</p>	<p>Nenet 8 dhe 9 bëjnë një zbërthim të mëtutjeshëm në lidhje me atë se cila nga pesë pozitat e detyrueshme duhet të zbatojë cilin komponent të detyrave dhe përgjegjësi. Shefi i zyrës në veçanti ka për detyrë të dorëzojë raport vjetor te kryetari i komunës dhe kuvendi, raporte të progresit në secilën mbledhje të KK-së, raporte tek institucionet qeveritare sipas kërkesës, si dhe propozim-buxhetin vjetor për funksionimin dhe aktivitetet. Ngjashëm, rolet e zyrtarit kanë të bëjnë në veçanti me ndarjen e informatave mbi të drejtat e komuniteteve, si dhe krijimin dhe mbajtjen e kontakteve të rregullta me këta individë.</p>	<p>Neni 11 po ashtu parasheh fleksibilitetin e komunave në lidhjen e marrëveshjeve ndërkomunale të bashkëpunimit, aktiviteteve të përbashkëta etj., për të siguruar zbatimin e Rregullores.</p>

## ▪ KORNIZA E POLITIKAVE

Termat e referencës apo Procedurat standarde të veprimit për ZKKK-të janë hartuar nga Ministria për Komunitete dhe Kthim në vitin 2011, për t'u ndihmuar komunave në zbatimin e Rregullores nr. 02/2010.<sup>28</sup> Ndryshe nga mekanizmat e tjerë të cilët kanë më pak detyra të përcaktuara qartë në kornizat përkatëse ligjore, Rregullorja nr. 02/2010 për ZKKK-të ofron mjaft qartësi për sa i përket rolit, përgjegjësi dhe funksionit të këtyre zyrave. Për këtë mekanizëm në veçanti, korniza e termave të referencës parasheh numrin më të lartë të detyrave themelore, andaj në këtë raport jepen vetëm disa shembuj të zgjedhur për të ilustruar përmbajtjen e tij nëpër kategoritë tematike.

### Detyrat kryesore themelore të përcaktuara me TeR që nuk janë trajtuar në Rregulloren nr. 02/2010 për zyrat komunale për komunitete dhe kthim (tabela d)

<b>Kontakti në terren dhe angazhimi i palëve të interesit</b>	<b>Vlerësimi i përfituesve</b>	<b>Monitorimi dhe raportimi</b>	<b>Planifikimi i zyrës dhe zhvillimi i projekteve</b>
Realizon vizita në terren, të paktën një herë në muaj, në secilin komunitet joshumicë (në të gjitha vendet) dhe personat e zhvendosur brenda komunës.	Vlerëson nevojat e komuniteteve joshumicë dhe personave të zhvendosur në komunë të paktën çdo gjashtë muaj.	Krijon mekanizma përmes të cilave komunitetet mund të marrin pjesë në monitorimin dhe vlerësimin e ndikimit të politikave komunale në të drejtat e tyre dhe qasjen në shërbime.	ZKKK-ja siguron zhvillimin dhe zbatimin e strategjisë 3-vjeçare të ZKKK-së, planit vjetor të punës dhe planeve individuale të punës.
Organizon takime një herë në tre muaj me udhëheqësit e organizatave të komuniteteve joshumicë dhe personave të zhvendosur në komunë.	Identifikon, bazuar në gjetjet e vlerësimit të nevojave, prioritetet dhe përcakton objektivat dhe pikëarritjet vjetore, si dhe i përfshin ato në planin vjetor të punës së ZKKK-së.	Kreu i ZKKK-së i dorëzon raporte kryetarit të komunës, kuvendit komunal dhe komiteteve të tij në baza javore, mujore, gjashtëmujore dhe vjetore në lidhje me veprimtarinë e zyrës dhe gjendjen e komuniteteve.	Harton buxhetin vjetor të ZKKK-së, i cili duhet të përgatitet me propozim-projekte me prioritet që synojnë komunitetet joshumicë. Raporton rregullisht për zbatimin e këtyre projekteve tek kryetari i komunës, Komiteti për Komunitete, si dhe institucionet e
Organizon takime tremujore me palët e interesit, dhe mban kontakte të	Harton materiale vetëdijësimi, si fletëpalosje, si dhe mundëson qasje të lehtë për		

<sup>28</sup> Ky dokument nuk gjendet në internet.



Vlerësim i **themelimit, funksionalizimit dhe performancës** së mekanizmave komunalë të pjesëmarrjes dhe përfaqësimit të komuniteteve

<p>rregullta me palët e interesit duke përfshirë kryetarin e komunës, NKK, ZKKKK, kryesuesin e KK, drejtoritë përkatëse komunale, Zyrën për Çështjet e Komuniteteve në kuadër të Zyrës së Kryeministrit, MKK, MAPL dhe organizatat ndërkombëtare.</p>	<p>komunitetet për të arritur ZKKK-të. Organizon takime tremujore me komunitetet dhe personat e zhvendosur.</p>	<p>Raportet gjashtëmujore dhe vjetore duhen publikuar, me kontributin nga komunitetet.</p>	<p>nivelit qendror sipas kërkesës.</p>
---	---	--	--


▪ **VLERËSIMI I ZYRËS KOMUNALE PËR KOMUNITETE DHE KTHIM**

Siç është theksuar tek pjesa e vlerësimit të Komitetit për Komunitete dhe në segmentin fillestar të këtij raporti, të dhënat e paraqitura në figurat grafike për secilën pyetje janë për vitin 2019. Treguesi shfaq nëse numri i ZKKK-ve që përmbushin kriteret është rritur apo është ulur në krahasim me vitin 2017. Këto gjetje bazohen në pyetjet nga pyetësi i përvitshëm i OSBE-së drejtuar përfaqësuesve nga secila ZKKK, plotësuar pastaj me vrojtimit e ekipeve të OSBE-së në terren. Emrat e saktë të komunave që përmbushin ose nuk përmbushin zotimet për secilën pyetje në këtë segment mund të gjenden në shtojcën e këtij raporti, mekanizmat sipas komunës, përveç nëse përcaktohet ndryshe.

**A është themeluar ZKKK-ja?<sup>29</sup> (35 Po, 3 Jo)**

ZKKK-të janë themeluar zyrtarisht në 35 komuna, përgjithësisht në periudhën 2010-2011.<sup>30</sup> Ndërsa numri i ZKKK-ve zyrtare ka mbetur i njëjtë midis viteve 2017 dhe 2019, disa ZKKK në Kosovë nuk janë themeluar në përputhje të plotë me detyrimet ligjore. Komunitat e vetme ku kjo zyrë nuk është themeluar janë Leposaviqi, Mitrovica Veriore dhe Zubin Potoku, ku ka zyrë të ngjashme, por jo ZKKK të themeluar. Kjo situatë ka mbetur e njëjtë si në vitin 2017 ashtu edhe në vitin 2019, dhe për pjesën tjetër të këtij segmenti këto komuna nuk

Nuk ka ndryshim nga viti 2017




<sup>29</sup> Neni 8, Rregullorja nr. 02/2010 për zyrat komunale për komunitete dhe kthim, (12 gusht 2010).

<sup>30</sup> Në komunat e Mitrovicës së Veriut, Leposaviqit dhe Zubin Potokut, zyrat titullohen zyrtarisht Zyra Komunale për Komunitete, të cilat janë themeluar nga administrata e UNMIK-ut, andaj në këtë pjesë këto zyra përjashtohen nga numërimi bashkë me ZKKK-të e themeluara mirëfilli.

merren parasysh, ndërsa kjo pyetje nuk do të shfaqet në aneksin e këtij raporti, mekanizmat sipas komunës.


### **A është hartuar dhe aprovuar plani i punës apo plani i aktiviteteve të ZKKK-së?<sup>31</sup> (Po 24, Jo 11, treguesi +1)**

Planet e punës nuk janë pjesë e kornizës ligjore që ka të bëjë me komunitetet, e vetmja dispozitë që është e ngjashme me planin e tillë është referenca ndaj një "plani veprimi" në lidhje me përgjegjësinë e zyrës për kthimin. Sidoqoftë, në kornizën e politikave, plani vjetor i punës ka rëndësi të konsiderueshme në punën e ZKKK-së, pasi zyra pritet të kryejë vlerësime të nevojave në komunën përkatëse, të shpërndajë gjetjet dhe të integrojë komentet në aktivitetet e tyre. Ngjashëm, korniza e politikave kërkon që projektet të menaxhohen dhe miratohen në përputhje me planin e punës së ZKKK-së. Ndërsa ky raport nuk ka matur se në çfarë mase komunat janë duke realizuar vlerësime të nevojave të komuniteteve, korniza e politikave e përcaktuar me Termat e referencës i kushton shumë rëndësi planit vjetor të punës së ZKKK-së nga perspektiva e komuniteteve. Megjithatë, kjo nuk pasqyrohet në legjislacionin përkatës. Hartimi i planeve të punës ka shënuar rritje marginale me një komunë midis viteve 2017 dhe 2019.



### **A ka nxjerrë ZKKK-ja raport vjetor me shkrim? Nëse jo, a ka ndonjë plan/zotim specifik për të raportuar?<sup>32</sup> (Po 27, Jo 8, treguesi +2)**

ZKKK-të kanë detyrimin ligjor të dorëzojnë raportin vjetor te kryetari i komunës dhe kuvendi i komunës. Kërkesa për raportim, përveç që është standard kyç i performancës dhe funksionalitetit i paraparë me ligj (tabela c), shpalosë njëherësh dhe veprimtarinë e zyrës dhe gjendjen e komuniteteve, siç parashihet me kornizën e politikave (tabela d). Gjersa rëndësia e raportit vjetor është e dukshme, nuk ka ndonjë afat të qartë kohor brenda të cilit duhet të përfundohen raportet vjetore. Në vitet 2017 dhe 2019, u vu re se në shumë raste ZKKK-të ishin në proces të finalizimit të raporteve të tyre në fund të dhjetorit ose në fillim të janarit të vitit vijues. Disa komuna tashmë i kishin proceduar raportin kuvendit, disa komuna të tjera tashmë kishin nxjerrë raportin para kuvendeve komunale, ndërsa disa komuna raportonin ta kishin dorëzuar raportin e ZKKK-së




<sup>31</sup> Neni 8, Rregullorja nr. 02/2010 për zyrat komunale për komunitete dhe kthim, (12 gusht 2010).

<sup>32</sup> Po aty.

si pjesë e raportit vjetor të kryetarit të komunës. Në vend të një afati ligjor ose formati ligjërish të detyrueshëm, komunat e vlerësuara në këtë raport janë shqyrtuar nëse e kanë nxjerrë raportin ose po planifikonin ta bënin së shpejti, përfshirë rastet e përfshirjes në raportin vjetor të kryetarit të komunës, që po ashtu kishte ndodhur, por në masë më të vogël, në periudhën prej vitit 2017 deri 2019. Në këtë aspekt, kjo kategori vlerësimi shënoi një përmirësim të vogël me tri komuna.

### **A ka vendosur ZKKK-ja kontakte me të gjitha komunitetet dhe kategoritë e përfituesve (p.sh. të kthyerit, personat e riatdhesuar ose rastet sociale nga radhët e komuniteteve joshumicë)?<sup>33</sup> (Po 34, Jo 1, treguesi -1).**

Legjislacioni (tabela c) thotë që ZKKK-ja duhet të krijojë dhe mbajë kontakte të rregullta me komunitetet joshumicë. ZKKK-të në mbarë Kosovën kanë arritur pajtueshmëri gati të plotë ligjore me këtë detyrë themelore. Ndërsa ky ligj përcakton detyrën themelore, që po përmbushet në formë të caktuar nga secila komunë, shtjellimi i mëtejshëm i kësaj detyre në Termat e referencës (tabela d) përcakton që komunikimi i tillë duhet të përfshijë mes tjerash takime tremujore me palët e interesit, komunitetet joshumicë, personat e zhvendosur dhe institucionet përkatëse, vizitat mujore në terren dhe shpërndarjen



e fletëpalosjeve informuese mbi përgjegjësitë e ZKKK-së në komunë. Përgjigjet nga bashkëbiseduesit në tërë Kosovën tregojnë se kjo ka marrë formë të ndryshme në komuna, të cilat në shumicën e rasteve vendosin kontakte të ngushta me komunitetet joshumicë. Disa komuna kanë raportuar se këtë e bëjnë këtë përmes projekteve të ndërlidhura me kthimin, si dhe në masë shumë më të vogël, të tjerat raportojnë të kenë krijuar kontakte, por më rrallë, ose ndoshta në mënyrë rastësore, derisa vetëm një komunë sipas monitorimit nuk ka organizuar asnjë vizitë në terren gjatë vitit. Prandaj, përgjigjet pozitive tregojnë përmbushje në një masë të detyrimit minimal ligjor, por përgjithësisht në shumë pak pika të kornizës shumë më të detajuar dhe më ambicioze të politikave. Në total, të gjitha komunat e përmbushnin këtë detyrim në vitet 2017 dhe 2019, përveç Kllokotit në 2019, rënie kjo me një komunë të vetme. Meqenëse komunat e sakta për vitet 2017 dhe 2019 janë të qarta, kjo pyetje nuk paraqitet në shtojcën e raportit, mekanizmat sipas komunës.


### **A ka punuar ZKKK-ja në hartimin, monitorimin ose vlerësimin e projekteve në dobi të komuniteteve?<sup>34</sup> (Po 18, Jo 17, treguesi +2)**

Detyra themelore për hartim, zbatim dhe monitorim të projekteve për të drejtat dhe interesat e komuniteteve rrjedh nga korniza ligjore, si dhe është paraqitur edhe në Terma të referencës, sipas së cilës ZKKK-ja duhet të konsultohet me KK-në dhe kuvendin e komunës

<sup>33</sup> Po aty, neni 9.

<sup>34</sup> Po aty.

për zgjedhjen e projekteve, të dorëzojë projektbuxhete për projektet, si dhe të raportoje rregullisht në KK për zbatimin e këtyre projekteve (tabela c dhe d). Projektet në periudhat e raportimit 2017 dhe 2019 shpesh drejtoheshin ose zhvilloheshin nga, mes tjerash, Organizata Ndërkombëtare për Migrimin (IOM), Këshilli Danez për Refugjatë (DRC), programi i sponsorizuar nga BE për kthim dhe riintegrim në Kosovë. Në vitin 2019, bashkëpunimi midis ZKKK-së dhe një partneri ndërkombëtar ose joqeveritar përbënte 14 nga 18 përgjigje pozitive. Rastet kur këto organizata punonin me ZKKK-të, përfshinin mes tjerash rastet kur ZKKK-ja ishte e angazhuar në bashkëfinancim të shtëpive të kulturës (Gjilan), identifikim të përfituesve për rinovimet e shtëpive (Mitrovicë), rindërtim të shtëpive për romët, ashkalinjtë dhe egjiptianët e Kosovës (Gjakovë), si dhe në mbështetjen e projektit për ndihmë bujqësore të një organizate ndërkombëtare (Prizren). Në disa prej komunave ku ZKKK-të menaxhonin projektet e tyre vetanake, ato kishin iniciuar shpërndarjen e librave shkollorë dhe sigurimin e druve të zjarrit për familjet në nevojë nga radhët e komuniteteve joshumicë (Podujevë), zbatonin projekte të ndërtimit të kanalizimit dhe asfaltimit të rrugëve në zonat ku banojnë komunitetet joshumicë (Istog), mes shembujve të tjerë të cilët kryesisht përqendroheshin në avancimin e infrastrukturës për komunitetet joshumicë.



## ▪ PËRMBLEDHJE E GJETJEVE - ZYRA KOMUNALE PËR KOMUNITETE DHE KTHIM

Korniza ligjore dhe ajo e politikave për ZKKK-të parashohin detyra të shumta për zyrën. Ngjashëm me mekanizmat e tjerë të vlerësuar në këtë raport kundrejt standardeve minimale të kornizës ligjore ose standardeve minimale të zgjedhura në kornizën e politikave, ZKKK-të në të gjithë Kosovën përgjithësisht kanë përmbyshur një numër relativisht të madh të detyrave.

- Gati një dekadë nga nxjerrja e Rregullores nr. 02/2010 për përcaktimin dhe rregullimin e ZKKK-ve në gjithë Kosovën, krijimi i ZKKK-ve në pothuaj mbarë vendin është arritje pozitive. Në anën tjetër, kriteret për themelimin e mirëfilltë të ZKKK-ve që përfshijnë integrimin e tyre në statutin e komunës nuk kanë gjetur zbatim në tërë Kosovën, gjë që pengon arritjen e pajtueshmërisë së plotë me kornizën ligjore.
- Raportet vjetore me shkrim mbeten standard i rëndësishëm i performancës dhe ofrojnë dukshmëri të punës së zyrës para kuvendit komunal, por edhe transparencë ndaj komunës. Në këtë drejtim, kjo gjë mund të përforcohet në komunat ku nuk ka asnjë lloj raportimi vjetor. Nuk ka ndonjë afat të caktuar kohor brenda të cilit raportet me shkrim duhen dorëzuar në kuvend, ose për formatin në të cilin duhet të dorëzohen, qoftë si pjesë

përbërëse e raportit të kryetarit, raport i pavarur ose tjetër lloj forme. Korniza e politikave ofron udhëzime zbatimi në këtë drejtim.

- Ndërsa korniza ligjore përcakton standard specifik për ZKKK-të që të hartojnë planin e veprimit në punën e vet në agjendën e kthimit, e njëjta nuk ekziston për komunitetet. Kjo është veçanërisht e dukshme kur merret parasysh fokusi i projekteve dhe aktiviteteve të ZKKK-së, si dhe që korniza e politikave i kushton shumë rëndësi vlerësimit të nevojave të ZKKK-së, si mekanizëm për ta pasuruar planin vjetor të punës për punën e ardhshme të zyrës, por edhe pothuajse të gjitha aspektet e punës së saj. Ngjashëm, duke pasur parasysh se ekziston një rregullore shumë më e detajuar për punën e ZKKK-së me të kthyerit<sup>35</sup>, një rregullore e ngjashme mund të hartohet për të avancuar më tej punën e ZKKK-së për sa u përket komuniteteve, duke ngritur nivelin e disa aspekteve të kornizës së politikave në ligj.
- ZKKK, si zyrë e përhershme me përgjegjësi për hartimin, zbatimin dhe monitorimin e projekteve në dobi të komuniteteve, ka funksion të rëndësishëm në ushtrimin e të cilit ka vazhduar të tregojë zhvillime pozitive dhe rezultate të prekshme të zhvillimit. Duke ditur që shumica e ZKKK-ve hartojnë projektet me varësi relativisht të lartë tek organizatat ndërkombëtare, nxitja e menaxhimit të pavarur të projekteve është fushë ku do të ishte dobiprurëse të ndërtoheshin kapacitetet e zyrave. Ngjashëm, ZKKK-të mund të përfitojnë nga modelet standarde për projekte dhe aktivitete, në të njëjtën mënyrë siç janë krijuar tashmë, për shembull, modelet e raportimit për mekanizmin e Komiteteve për Komunitete.

---

<sup>35</sup> Rregullorja nr. 01/2018 për kthimin e personave të zhvendosur dhe zgjidhje të qëndrueshme, (4 Janar 2018).

## NËNKRYETARI I KOMUNËS PËR KOMUNITETE

NKK është mekanizëm tjetër i paraparë me LVQL, si dhe është pozitë e detyrueshme për ato komuna popullsia e të cilave përbëhet nga të paktën dhjetë për qind të komuniteteve që nuk janë shumicë. Këto pozita janë krijuar gjithashtu në disa komuna ku popullsia nuk përbëhet nga të paktën dhjetë për qind të komuniteteve joshumicë, gjë që po ashtu trajtohet në këtë segment.

### ▪ KORNIZA LIGJORE

#### Detyrat themelore sipas kornizës ligjore

Korniza ligjore sa i përket NKK-së është shumë e gjerë dhe ka paraparë pak detyra të drejtpërdrejta që duhen përmbushur. Ç' është më e rëndësishme, dispozitat e LVQL-së që e përkufizojnë këtë mekanizëm parashohin se NKK zgjidhet për të njëjtin mandat si kryetari i komunës dhe duhet të ofrojë këshilla për kryetarin për çështje që lidhen me komunitetet joshumicë.<sup>36</sup> Përtej këtyre këshillave të kufizuara, *Udhëzimi administrativ nr. 01/2014 për procedurën e emërimit të nënkryetarëve në komuna* ka dhënë një numër të kufizuar të sqarimeve, duke paraparë që NKK "mbështetë dhe afirmon kërkesat e komuniteteve [joshumicë] në organet komunale".<sup>37</sup> Megjithëse kjo dispozitë është e gjerë, duket se u jep komuniteteve joshumicë qasje më të drejtpërdrejta në institucionet komunale përmes NKK-së, edhe pse përndryshe ky akt nënligjor përforcon detyrimet ekzistuese të parapara në LVQL.

Ndonëse nuk merret parasysh në raport, ngaqë ka hyrë në fuqi në shtator të vitit 2020 dhe si i tillë është jashtë kornizës kohore të vlerësimit, *Udhëzimi administrativ nr. 02/2020 për procedurën e emërimit të nënkryetarëve në komuna*<sup>38</sup> është rregullorja më e fundit me detyrat themelore për këtë mekanizëm. Ky udhëzim parashtron detyrat themelore më të detajuara për këtë mekanizëm deri më tani, e ç'është më me rëndësi, aty shtohet që NKK-ja konfirmon kërkesat e komuniteteve joshumicë para organeve komunale, duke përfshirë raportet e rregullta të kryetari i komunës për këto kërkesa. Aty thuhet që, në konsultim me kryetarin e komunës, nevojat dhe interesat e komuniteteve joshumicë merren parasysh gjatë përgatitjes së buxhetit të komunës. Aty gjithashtu thuhet se në bashkërendim me ZKKKK-në, NKK promovon dialogun midis komuniteteve dhe përfshirjen e komuniteteve joshumicë, përtej pjesëmarrjes në mbledhjet e kuvendit të komunës.

#### Kriteret për përzgjedhjen e nënkryetarit të komunës sipas kornizës ligjore

Në LVQL, emërimi dhe shkarkimi i NKK-së propozohet nga kryetari i komunës, me miratimin e shumicës së anëtarëve të kuvendit që janë të pranishëm dhe votojnë, si dhe shumicës së anëtarëve të kuvendit nga radhët e komuniteteve joshumicë që janë të pranishëm dhe

<sup>36</sup> Neni 61.3, Ligji nr. 03/L-040 për vetëqeverisjen lokale (4 qershor 2008).

<sup>37</sup> Udhëzimi administrativ nr. 01/2014 për procedurën e emërimit të nënkryetarëve në komuna, (28 Janar 2014).

<sup>38</sup> Udhëzimi administrativ no.02/2020 për procedurën e emërimit të nënkryetarëve në komuna (21 shtator 2020).

votojnë. NKK-ja zgjidhet për të njëjtin mandat si kryetari i komunës, dhe nëse pozita mbetet e lirë NKK i ri duhet të propozohet brenda 30 ditëve.

Kjo procedurë është qartësuar më tej me *Udhëzimin administrativ të vitit 2014 për procedurën e emërimit të nënkryetarëve në komuna*, që është më i qartë në kriteret e përzgjedhjes. Sipas këtij Udhëzimi administrativ, aty ku pozita e NKK është e detyrueshme, kandidati duhet të emërohet nga kryetari i komunës dhe më pas të miratohet nga shumica e anëtarëve të kuvendit, si dhe anëtarët e KK-së që u përkasin komuniteteve joshumicë. Në komunat ku nuk është pozitë e detyrueshme, NKK emërohet vetëm me vendim të kuvendit të komunës. Kushti në të dy rastet është që NKK-ja të zgjidhet nga radhët e grupit më të madh pakicë në komunë. Udhëzimi administrativ po ashtu thekson që kohëzgjatja e emërimit është e njëjtë me atë të kryetarit, përveç nëse shkarkohet, si dhe shton një kusht përfundimtar, që NKK-ja duhet të ketë qenë banor i komunës për tri vitet e fundit. Edhe pse shumica e dispozitave janë të pandryshuara nga Udhëzimi administrativ i vitit 2014, Udhëzimi i ri administrativ i nxjerrë në vitin 2020 bën një ndryshim modest në procedurën për këtë çështje, ashtu që nuk ka dallim midis emërimit të NKK-së në rastet ku kjo pozitë është e detyrueshme dhe atyre që nuk janë.

### **Shfuqizimi i Udhëzimit administrativ nr. 01/2014**

Në një vendim të ministrit të Administrimit të Pushtetit Lokal, të datës 11 shtator 2019, *Udhëzimi administrativ nr. 01/2014 për procedurën e emërimit të nënkryetarëve në komuna* u shfuqizua.<sup>39</sup> Ndërsa ky vendim është në fuqi që nga 11 shtatori 2019, ai nuk filloi së zbatuari deri në muajt e fundit të vitit, para periudhës së emërimit të ndonjë prej NKK-ve aktualë. Për qëllimet e këtij raporti dhe në këtë kontekst, *Udhëzimi administrativ nr. 01/2014 për procedurën e emërimit të nënkryetarëve në komuna* merret megjithatë parasysh në vlerësimin e këtyre mekanizmave. Legjislacioni zëvendësues erdhi në formën e *Udhëzimit administrativ nr. 02/2020 për procedurën e emërimit të nënkryetarëve në komuna*<sup>40</sup> më 21 shtator 2019, siç përshkruhet në segmentet e detyrave themelore dhe të kriterëve të përzgjedhjes në këtë kapitull.

## **▪ KORNIZA E POLITIKAVE**

Shumica e hollësive në lidhje me detyrat themelore të këtij mekanizmi janë paraparë me Termat e referencës për nënkryetarët e komunave për komunitete, hartuar nga Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal në vitin 2014<sup>41</sup>, në vend të kornizës ligjore. Këta Terma reference u hartuan për të përcaktuar "fushëveprimin e plotë të detyrimeve dhe përgjegjësi [të NKK-ve]". Përveç tabelës së detyrave themelore që paraqiten në Terma të referencës, të renditura më poshtë (tabela e), ka gjithashtu një shtesë ku përcaktohet se

<sup>39</sup> Vendimi i ministrit të Administrimit të Pushtetit Lokal (11 shtator 2019), <https://mapl.rks-gov.net/wp-content/uploads/2019/09/039-152-4-2014-2.pdf>.

<sup>40</sup> Udhëzimi administrativ nr.02/2020 për procedurën e emërimit të nënkryetarëve në komuna (21 shtator 2020).

<sup>41</sup> Ky dokument nuk gjendet në internet.

faktorët vijues duhet të merren parasysh me rastin e zgjedhjes së një kandidati për këtë post: pozita brenda komunitetit përkatës, shkalla e angazhimit dhe njohurive për komunitetin, si dhe natyra dhe marrëdhëniet me pjesëtarët e komunitetit.

### **Detyrat themelore të parapara me TeR, por që nuk paraqiten në legjislacionin përkatës për NKK<sup>42</sup> (tabela e)**

<b>Siguron që në buxhet të parashihet financim i mjaftueshëm</b>	<b>Siguron ruajtjen e të drejtave të komuniteteve dhe qasje të barabartë në shërbime për komunitetet</b>	<b>Dialogu ndërmjet komuniteteve, si dhe përfshirja e komuniteteve në aktivitete</b>	<b>Komunikimi dhe përfaqësimi kundrejt komuniteteve joshumicë</b>	<b>Raportimi</b>
Avokon për komunitetet joshumicë gjatë procesit të përgatitjes së buxhetit.	NKK mund të ngarkohet nga kryetari i komunës me mbikëqyrjen e zbatimit të aktiviteteve nga ZKKK-të.	Në bashkërendim me ZKKKK-në, promovon përfshirjen e komuniteteve joshumicë në aktivitetet e kuvendit si buxheti, projektet, strategjitë komunale.	Siguron që të ofrohet platforma e debatit për çështjet me interes për komunitetet joshumicë, si dhe siguron që të mbahen takimet publike për të kontaktuar me komunitetet joshumicë.	Çdo 6 muaj, NKK i dorëzon raport kryetarit të komunës, i cili pas miratimit, bëhet pjesë përbërëse e raportit 6-mujor të kryetarit të komunës para kuvendit.
Sigurohet që fonde të mjaftueshme të parashihen për mekanizmat komunalë për promovimin dhe mbrojtjen e të drejtave të komuniteteve, duke përfshirë ZKKK-në.	Mbështet bashkëpunimin midis KK-së dhe ZKKK-së.	Inkurajon bashkëpunimin ndërkomunal për sa i përket komuniteteve dhe shërben si pikë kontakti.	Kërkon që rregullisht të takohet me mekanizmat dhe palët e tjera të interesit në komunë.	NKK bën prezantimin verbal të raportit në KK, pasi kryetari i komunës ta ketë prezantuar raportin para kuvendit.
Bashkëpunon me KK-në gjatë fazave të shqyrtimit dhe	Shërben si pikë kontakti për zbatimin e rekomandimeve të KK-së, si dhe politikave të tjera të miratuara nga kuvendi në lidhje me komunitetet, si			

<sup>42</sup> Vini re se kjo tabelë i referohet detyrave themelore të parapara me TeR, që nuk paraqiten në legjislacionin përkatës për NKK në periudhën e vlerësuar me raport. Siç shpjegohet në kapitullin e detyrave themelore, udhëzimi i ri administrativ i shtatorit 2020 përmban detyra të reja themelore që përgjithësisht bazohen në Termat e referencës për NKK.



Vlerësim i **themelimit, funksionalizimit dhe performancës** së mekanizmave komunalë të pjesëmarrjes dhe përfaqësimit të komuniteteve

miratimit të buxhetit.	dhe koordinohet me ZKKKK-të.	Mund të marrë pjesë rregullisht në mbledhjet e kuvendit, mbledhjet e Komitetit, takimet e Këshillit Komunal të Sigurisë në Bashkësi, ZKKKK-së.	NKK duhet të takohet me kryetarin e komunës të paktën një herë në muaj për të diskutuar çështje të lidhura me komunitetet.
NKK duhet të ketë qasje adekuate në burimet komunale.			

▪ **VLERËSIM I POZITËS SË NËNKRYETARIT TË KOMUNËS PËR KOMUNITETE**

**Themelimi i pozitës së NKK**

Megjithëse regjistrimi i vitit 2011 nuk konsiderohet shprehimisht si standard sipas së cilit kjo pozitë është i detyrueshme ose jo, ky raport përdorë regjistrimin si bazë për përcaktimin e komunave ku pozita e NKK-së duhet të jetë e detyrueshme.<sup>43</sup> Në komunat ku nuk është mbajtur regjistrimi, Leposaviq, Mitrovicë Veriore, Zubin Potok dhe Zveçan, për qëllime të këtij raporti, aty ku të dhënat e regjistrimit nuk janë në dispozicion, përdoret vlerësimi i popullatës nga Profilet Komunale të OSBE-së të vitit 2018<sup>44</sup>. Me këtë njësi matjeje, vetëm Mitrovica Veriore e kalon prapun e dhjetë për qindëshit, megjithatë kjo komunë nuk kishte pozitë të NKK-së në vitin 2019. Në këtë raport, Mitrovica Veriore do të konsiderohet se ka pozitë të detyrueshme të paplotësuar të NKK-së.

Duke përdorur regjistrimin e popullsisë si njësi matjeje, NKK-të janë të detyrueshëm në Dragash, Fushë Kosovë, Graçanicë, Kllokot, Novobërdë, Prizren dhe Shtërpçë. Pavarësisht se ishte i detyrueshëm, në vitin 2019 pozita e NKK-së nuk ishte krijuar në Graçanicë.

**Statusi ligjor i pozitave jo të detyrueshme të NKK-së**

Në vitin 2019, NKK-të ishin aktive në shtatë<sup>45</sup> komuna ku komunitetet joshumicë përbëjnë më pak se dhjetë për qind të popullsisë së përgjithshme sipas regjistrimit të popullatës të vitit 2011<sup>46</sup> ose sipas vlerësimeve që ndodhen në Profilet e komunave të Kosovës të

<sup>43</sup> Ndërsa shifrat e sakta të popullsisë janë të paqarta në komunat ku nuk është mbajtur regjistrimi, Leposaviq, Mitrovicë e Veriut, Zubin Potok dhe Zveçan, për qëllime të këtij raporti, aty ku të dhënat e regjistrimit nuk janë në dispozicion, përdoret vlerësimi i popullatës nga Profilet Komunale të OSBE-së të vitit 2018. Duke përdorur këtë metrikë, vetëm Mitrovica Veriore e kalon prapun e dhjetë për qindëshit.

<sup>44</sup> Raport i OSBE-së, *Përmbledhje e të gjitha profileve të komunave 2018*, (29 janar 2019) <https://www.osce.org/mission-in-kosovo/410279?download=true>

<sup>45</sup> Kamenicë, Lipjan, Mamushë, Obiliq, Ferizaj, Zubin Potok, Zveçan.

<sup>46</sup> Raporti për regjistrimin e popullsisë në vitin 2011 është në dispozicion tek: <https://ask.rks-gov.net/en/kosovo-agency-of-statistics/social/population-and-housing-census>.

përpiluara nga Misioni i OSBE-së në vitin 2018.<sup>47</sup> Për qëllime të këtij raporti, këta konsiderohen si NKK jo të detyrueshëm. Baza ligjore për pozitën jo të detyrueshme të NKK-ve gjendet vetëm në nenin 4.2 të *Udhëzimit administrativ nr. 01/2014 për procedurën e emërimit të nënkryetarëve në komuna* i cili flet rreth procedurës së emërimit të NKK-ve në komunat që nuk e plotësojnë prapësinë prej dhjetë për qind. Me përfshirjen e tyre në këtë udhëzim administrativ, nënkuptohet që këto pozita janë të lejueshme ligjërisht.

Megjithatë, neni 4.2 i *Udhëzimit administrativ nr. 01/2010 i MAPL-së për kufizimin e kompensimit dhe marrjes së pagesës nga zyrtarët e komunave* parasheh shprehimisht që komunat të cilat e plotësojnë prapësinë e komuniteteve joshumicë që përbëjnë më shumë se dhjetë për qind të popullsisë kanë të drejtë të kenë NKK i cili merr pagë. Nga kjo dispozitë shihet, se ato komuna që nuk e plotësojnë prapësinë e dhjetë përqindëshit nuk kanë të drejtë të kenë NKK me pagë, ndryshe nga ato komuna që e kanë NKK të detyrueshëm. Ky Udhëzim administrativ, nuk ofron asnjë formë matjeje për të përcaktuar nëse komuna e plotëson ose jo prapësinë e dhjetëpërqindëshit. Megjithatë ka hyrë në fuqi jashtë periudhës së vlerësuar, Udhëzimi administrativ i lartpërmendur i vitit 2020 *për procedurën e emërimit të nënkryetarëve në komuna* jep më shumë qartësi rreth NKK-ve jo të detyrueshëm duke theksuar se në komunat ku komunitetet joshumicë përbëjnë më pak se dhjetë për qind të popullsisë, komuna gjithmonë e ka mundësinë e emërimit të NKK-së bazuar në burimet financiare.

### **Përkatësia e komunitetit në pozitën e NKK-së**

Siç është përshkruar në kornizën ligjore, këto pozita mbahen nga komuniteti më i madh joshumicë në komunë. Ndërsa ky segment nuk vlerëson nëse janë përmbushur të gjitha modalitetet e emërimit, vërehet se nga 12 pozita të NKK të krijuara, tetë<sup>48</sup> ishin anëtarë të komunitetit më të madh joshumicë, kurse NKK-të për katër<sup>49</sup> komunat e tjera nuk i përkitnin komunitetit më të madh sipas regjistrimit të popullsisë ose vlerësimit përkatës të përdorur nga ky raport.

### **Vlerësim i përmbushjes së angazhimeve ligjore dhe të politikave në lidhje me NKK-në**

Siç është vënë në dukje në komponentët e tjerë të vlerësimit të këtij raporti, pyetjet e paraqitura më poshtë janë marrë nga një anketë e përvitshme e realizuar me përfaqësuesit e secilit mekanizëm, ku përfaqësuesi, në këtë rast NKK, u përgjigjet pyetjeve të cilat bazohen në aspektet kryesore të kornizës ligjore ose të politikave. Këto anketa plotësohen më tutje nga vëzhgimet e ekipeve të OSBE-së në terren. Të dhënat e këtij segmenti të shfaqura nëpër diagrame për secilën pyetje janë nga fundi i vitit 2019. Këto gjetje bazohen në pyetjet nga pyetësi i përvitshëm i OSBE-së drejtuar përfaqësuesve nga secila ZKKK, plotësuar pastaj me vëzhgimet e ekipeve të OSBE-së në terren. Emrat e saktë të komunave që përmbushin ose nuk përmbushin zotimet për secilën pyetje në këtë segment mund të gjenden në shtojcën e këtij raporti, mekanizmat sipas komunës, përveç nëse përcaktohet ndryshe, gjersa komunat

<sup>47</sup> Raport i OSBE-së, *Përmbledhje e të gjitha profileve të komunave*, (29 janar 2019), <https://www.osce.org/mission-in-kosovo/410279?download=true>.

<sup>48</sup> Ferizaj, Kamenicë, Fushë Kosovë, Lipjan, Mamushë, Prizren, Zubin Potok, Zveçan.


<sup>49</sup> Dragash, Kllokot, Novobërdë, Shtërpçë.

ku kjo pozitë është e detyrueshme por që nuk është plotësuar janë çdoherë Graçanica dhe Mitrovica Veriore dhe nuk janë paraqitur në shtojcë.


**A i ka dhënë NKK këshilla dhe udhëzime specifike kryetarit të komunës për çështje të komuniteteve?<sup>50</sup> (NKK i detyrueshëm: 6 Po, 2 pozita të paplotësuara) (NKK jo i detyrueshëm: 7 Po)**

Aty ku kanë qenë të krijuara, në vitin 2019, NKK-të që konsiderohen të detyrueshme për këtë raport që të gjithë kanë ofruar këshilla dhe udhëzime specifike për kryetarin e komunës në çështjet që kanë të bëjnë me komunitetet. E njëjta gjë vlen edhe për NKK-të që konsiderohen jo të detyrueshëm për qëllime të këtij raporti. Rastet e dhënies së këshillave dhe rekomandimeve kanë përfshirë procesin e dënimit të incidenteve të përsëritura të sigurisë, udhëzime për komunitat rreth përdorimit të gjuhëve zyrtare, shpërndarjen e bursave për pjesëtarët e komuniteteve joshumicë dhe krijimin e projekteve të punësimit për komunitetet joshumicë. Dhënia e këshillave specifike dhe angazhimi i vazhdueshëm i mekanizmave në takimet e rregullta me kryetarin e komunës ilustron se NKK-të vazhdojnë të jenë avokues që janë në rrjedha dhe të rëndësishëm për komunitetet në shërbim të të cilave janë.

NKK të detyrueshëm në vitin 2019




NKK jo të detyrueshëm në vitin 2019



**A është siguruar NKK që ekzekutivi komunal (p.sh. ZKKK-ja dhe drejtoritë e tjera komunale) zbaton në mënyrë efektive projekte / aktivitete / politika / rregullore në lidhje me mbrojtjen dhe promovimin e të drejtave të komuniteteve?<sup>51</sup> (NKK i detyrueshëm: 5 Po, 1 Jo, 2 pozita të paplotësuara), (NKK jo i detyrueshëm: 7 Po, 0 Jo)**

Realizimi i aktiviteteve të projekteve dhe politikave buron nga korniza e politikave (tabela e) dhe rrit ndërveprimin e NKK-së me të gjitha drejtoritë dhe zyrat komunale. Ky aspekt i punës së NKK-së është realizuar mirë në Kosovë në të dyja rastet, si kur është i detyrueshëm ashtu edhe kur nuk është i detyrueshëm. Në mesin e NKK-ve të detyrueshëm, vetëm një nuk e ishte duke e përmbushur këtë

NKK të detyrueshëm në vitin 2019




<sup>50</sup> Neni 61.3, Ligji nr. 03/L - 040 për vetëqeverisjen lokale (4 qershor 2008).

<sup>51</sup> Termat e referencës për nënkryetarin e komunës për komunitete (2014), ndonëse nuk janë në dispozicion në internet, detyrat kryesore themelore janë paraqitur hollësisht në tabelën e.

detyrë, duke theksuar se kryetari i komunës nuk e ka autorizuar mbikëqyrjen e aktiviteteve të ZKKK-së dhe kompetencat për të bërë kërkesa në drejtoritë komunale janë të kufizuara. Për më tepër, nga ekipet në terren të OSBE-së u vërejt se tre NKK ishin më pak konsistent (Dragash, Mamushë, Prizren) në ndjekjen e rekomandimeve të KK-së dhe mbikëqyrjen e zbatimit të aktiviteteve të ZKKK-së në komunat e tyre përkatëse, megjithëse këta NKK ishin në kontakt të rregullt me ZKKK-në. Ngjashëm ishte dhe përvoja e NKK-ve jo të detyrueshme. Ndërsa në rastin e një NKK u vërejt se kishte përcjellje më pak të qëndrueshme të zbatimit efektiv të aktiviteteve, veçanërisht për sa i përket ZKKK-së, të tjerët ishin përgjithësisht mjaft aktiv. Shembuj të aktiviteteve të mbikëqyrura përfshinin planet e punës së ZKKK-së, mbështetjen e OJQ-ve lokale në shënimin e ditëve zyrtare të komuniteteve romë të Kosovës dhe ashkali të Kosovës, iniciativat për punësim dhe shpërndarjen e druve të zjarrit.


NKK jo të detyrueshëm në vitin 2019




**A ka promovuar NKK dialogun ndërmjet komuniteteve?<sup>52</sup> (NKK i detyrueshëm: 3 Po, 3 Jo, 2 pozita të paplotësuara), (NKK jo i detyrueshëm: 3 Po, 4 Jo)**

Dialogu ndërmjet komuniteteve gjithashtu parashihet si detyrë në kornizën e politikave për ZKKK (tabela e) dhe mund të shërbejë si angazhim i përbashkët për këta dy mekanizma që të bashkëveprojnë më shumë. Në mesin e NKK-ve të detyrueshëm, dialogu ndërmjet komuniteteve nuk është trajtuar në mënyrë specifike, përveç në dy komuna ku, për shembull, komuna me ndihmën e OSBE-së e ka mbështetur shkëmbimin ndërmjet nëpunësve civilë shqiptarë dhe serbë për dialog ndërmjet komuniteteve. Gjersa komunat tjera e kanë përmbushur këtë zotim pjesërisht, veprimet ishin më pak specifike dhe përfshinin pjesëmarrjen e NKK-së në ngjarje në komunitet, ose ngritjen e vetëdijes për çështje të ndryshme në forume të tjera si këshillat komunalë të sigurisë në bashkësi. NKK-të jo të detyrueshëm performuan më mirë dhe aktivitetet për të promovuar dialogun ndërmjet komuniteteve kanë përfshirë aktivitete specifike në kuadër të organizimeve sportive ndëretnike të mbështetura nga IOM-i dhe aktivitete të dialogut ndërmjet komunës dhe

NKK të detyrueshëm në vitin 2019



NKK jo të detyrueshëm në vitin 2019




<sup>52</sup> Po aty.

të kthyerve nga radhët e komunitetet joshumicë. Emrat e saktë të komunave në fjalë janë dhënë në shtojcë, mekanizmat sipas komunës.

**A takohet NKK me kryetarin e komunës të paktën çdo muaj për të diskutuar çështje të lidhura me komunitetet dhe aktivitetet e vazhdueshme?<sup>53</sup> (NKK i detyrueshëm: 5 Po, 1 Jo, 2 pozita të paplotësuara), (NKK jo i detyrueshëm: 7 Po)**


Takimi midis NKK-së dhe kryetarit të komunës në interval prej të paktën një herë në muaj është një detyrë themelore e paraparë me kornizën e politikave (tabela e) dhe njëherësh një shtjellim i prekshëm i përcaktimit të NKK-së me kornizë ligjore si këshilltar i kryetarit të komunës për çështje që kanë të bëjnë me komunitetet. Në këtë drejtim, ky format i takimeve është standard minimal i rëndësishëm për të siguruar që zëri i NKK-së të dëgjohet drejtpërdrejt nga kryetari i komunës rregullisht. Në mesin e komunave me NKK të detyrueshëm, që të gjitha përveç njërës e përmbushin këtë angazhim minimal, ku shumica shprehen se ndërveprimi ndodh më shpesh se një herë në muaj. Aty ku ky zotim minimal nuk ishte përmbushur, ishte për shkak të faktit se kryetari i komunës refuzon të takohet me NKK-në (Klllokot). NKK-të tjerë, si ata të detyrueshëm ashtu edhe jo të detyrueshëm, që të gjithë po e përmbushnin këtë zotim dhe, në mënyrë të ngjashme, shumica deklaruan se takoheshin me kryetarin e komunës më shpesh sesa një herë në muaj, madje edhe në baza javore ose ditore. Këto të dhëna çimentojnë faktin se në pothuajse çdo rast, NKK është pjesë e rëndësishme e strukturës komunale të vendimmarrjes, gjë që është zhvillim shumë pozitiv për këtë mekanizëm.

NKK të detyrueshëm në vitin 2019



■ Po ■ Jo ■ E paplotësuar

NKK jo të detyrueshëm në vitin 2019



■ Po ■ Jo

▪ **PËRMBLEDHJE E GJETJEVE - NËNKRYETARI I KOMUNËS PËR KOMUNITETE**

- *Udhëzimi administrativ nr. 01/2014 për procedurën e emërimit të nënkryetarëve në komuna kishte qenë prej kohësh i vetmi akt nënligjor i LVQL-së që i referohej NKK-së dhe parashihte detyra të rëndësishme, megjithëse të kufizuara, por edhe përbërje dhe kritere të rëndësishme të përzgjedhjes. Ndonëse nuk është pjesë e periudhës kohore të vlerësimit të këtij raporti, Udhëzimi i ri administrativ i nxjerrë në vitin 2020 për këtë çështje është i rëndësishëm për të ardhmen e këtij mekanizmi.*

<sup>53</sup> Po aty.

- Të dhënat shpalosin se NKK-të jo të detyrueshëm në përgjithësi po i zbatojnë detyrat themelore më shumë sesa homologët e tyre të detyrueshëm. NKK-të në mbarë vendin kanë dëshmuar se mund të bëjnë ndryshim drejt avancimit të të drejtave dhe interesave të komuniteteve joshumicë. Megjithëse emërimi i NKK-ve jo të detyrueshëm është përcjellë me paqartësi juridike në të kaluarën, Udhëzimi administrativ i vitit 2020 i diskutuar në këtë kapitull është masë e dobishme për ta sqaruar krijimin e tyre në një rrugë të qartë ligjore në të ardhmen.
- NKK-të e krijuara janë integruar në masë të madhe në infrastrukturën vendimmarrëse të komunës, me më shumë takime me kryetarin e komunës se sa që parashihet në kornizën e politikave, dhe faktin se NKK-të kanë në përgjithësi bashkëpunim të fuqishëm dhe ndërveprime me strukturat ekzekutive komunale. Në disa rrethana kur NKK është anashkaluar, pasi që kërkohet të zhvillohen pak takime me kryetarin e komunës ose ekzekutivin komunal, kjo është fushë që mund të forcohet në aspektin ligjor për të ndihmuar në zbutjen e kësaj sfide dhe vendosjen e përgjegjësisë së barabartë për ata bashkëbisedues me të cilët NKK është i detyruar për t'u takuar.
- Dialogu ndërmjet komuniteteve është pjesë përbërëse e mandatit të NKK-së si një nga detyrat e tij/saj themelore më të vogla. Megjithëse korniza e politikave është hartuar në mënyrë të qartë për të siguruar fushëveprimin e plotë të detyrave, kjo detyrë e veçantë merr shumë pak komente në lidhje me zbatimin praktik të saj. Praktikrat më të mira të shpjeguara në nivel të qeverisë ose modalitetet praktike të zbatimit do ta ndihmonin këtë mekanizëm dhe mekanizmat tjerë. Përfshirja e kësaj detyre në Udhëzimin administrativ të vitit 2020 është e dobishme për ngritjen e këtij aspekti të kornizës së politikave në legjislacion.

## ZËVENDËSKRYESUESI I KUVENDIT TË KOMUNËS PËR KOMUNITETE (ZKTKK)

### ▪ KORNIZA LIGJORE

ZKTKK mbanë rol që është i veçantë midis mekanizmave të vlerësuar në këtë raport. Kjo pozitë është përkufizuar në nenin 62 të Kushtetutës, fillimisht nën titullin "zëvendëskryetari për komunitete". Ndërsa emri i këtij mekanizmi ka ndryshuar me kalimin e kohës, karakteri i tij kushtetues, i diskutuar në segmentin e radhës, mbeti i njëjtë.

### **Detyrat themelore sipas kornizës ligjore**

Kushtetuta bën përshkrim të saktë dhe të qartë të detyrave themelore të ZKTKK-së, ku ai ka për detyrë të shërbejë si pikë qendrore e kontaktit për adresimin e brengave dhe interesave të komuniteteve joshumicë në takimet e kuvendit të komunës dhe në punën e saj. Funkzioni

më i rëndësishëm i përcaktuar me kushtetutë është se ZKXXX ka për detyrë të shqyrtojë pretendimet e komuniteteve kur ato besojnë se aktet dhe vendimet e kuvendit të komunës po shkelin të drejtat e tyre të garantuara me kushtetutë dhe, për më tepër, të drejtën për t'i referuar çështjet e tilla në kuvend për rishqyrtim. Në fund, ZKXXX-së i është dhënë mundësia e referimit të çështjeve drejtpërdrejt në Gjykatën Kushtetuese nëse i refuzohet rishqyrtimi në kuvendin e komunës. LVQL-ja e parasheh emrin e sotëm të kësaj pozite dhe, përveç kësaj, ia ngarkon edhe detyrën e dialogut ndërmjet komuniteteve.<sup>54</sup>

### **Kriteret e përzgjedhjes për ZKXXX-në sipas kornizës ligjore**

Përveç përcaktimit të tij si subjekt komunal, Kushtetuta parasheh kriteret specifike që lidhen me krijimin e kësaj pozite dhe zgjedhjen e bartësit të saj, gjegjësisht që është e detyrueshme në ato komuna ku të paktën dhjetë për qind e banorëve u përkasin komuniteteve joshumicë dhe se pozitën duhet ta mbajë cilido kandidat nga komuniteti joshumicë që ka marrë më shumë vota në listën e hapur të kandidatëve për zgjedhje në kuvendin e komunës. Për këto dispozita në mënyrë të ngjashme nuk janë dhënë hollësi shtesë në LVQL dhe, ndryshe nga NKK, nuk theksohet asgjë rreth lënies bosh të kësaj pozite.

### **▪ KORNIZA E POLITIKAVE**

Derisa korniza ligjore e mandaton ZKXXX-në me detyrën më të rëndësishme të mundësisë së adresimit të ankesave drejtpërdrejt në Gjykatën Kushtetuese, ajo parasheh për këtë mekanizëm numrin më të vogël të detyrave themelore. Si rrjedhojë, ai duhet të mbështetet edhe në kornizën e politikave për përcaktimin e tij si mekanizëm, dhe njëherësh në termat e referencës për ZKXXX-në që janë hartuar nga Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal në vitin 2015.<sup>55</sup> Derisa janë dhënë disa hollësi shtesë edhe në lidhje me procedurën e emërimit dhe shkarkimit, shtesa më e madhe cilësore janë detyrat themelore.

### **Detyrat themelore të parapara me TeR, por që nuk paraqiten në legjislacionin përkatës për ZKXXX-në (tabela f)**

<b>Promovon dialogun ndërmjet komuniteteve dhe përfshirjen e tyre në kuvendin e komunës.</b>	<b>Shërben si pikë zyrtare kontakti për komunitetet joshumicë.</b>	<b>Bashkëpunimi me mekanizmat e tjerë lokalë të komuniteteve.</b>	<b>Reportimi</b>
Përgjegjës për lehtësimin e dialogut ndërmjet komuniteteve në	Merr pjesë në takimet e kuvendit komunal dhe konsultohet për sa u	Mund të komunikojë përmes NKK-së me kryetarin e komunës për të ndërmarrë	Raporton rreth punës së tij para anëtarëve të

<sup>54</sup> Ligji nr. 03/L - 040 për vetëqeverisjen lokale (4 qershor 2008).

<sup>55</sup> Ky dokument nuk gjendet në internet.

<p>konsultim me kuvendin.</p> <p>Në bashkëpunim me NKK, lehtëson përfshirjen e komuniteteve në kuvendin e komunës, si dhe në takimet publike në lidhje me buxhetin dhe rregulloret komunale.</p>	<p>përket pikave të rendit të ditës që kanë të bëjnë me çështjet e komuniteteve, si dhe sugjeron politika në të mirë të komuniteteve.</p> <p>Merr pjesë në takimet e KK-së dhe bashkëpunon në shqyrtimin e politikave komunale që prekin interesat e komuniteteve.</p> <p>Siguron që rekomandimet e KK-së të diskutohen në takimet e kuvendit komunal.</p> <p>Siguron bashkëpunim të rregullt midis mekanizmave lokalë për mbrojtjen dhe promovimin e të drejtave të komuniteteve dhe organeve të tjera komunale.</p>	<p>veprime në lidhje me shkeljen e pretenduar të drejtave të pjesëtarëve të komunitetit.</p> <p>Bashkëpunon me ZKKK-në dhe mund të ketë qasje në raportet e rregullta nga ZKKK-ja të cilat i dorëzohen kuvendit të komunës.</p> <p>Përmes kryesuesit të kuvendit, mund të adresojë shqetësimet dhe nevojat që kanë të bëjnë me sigurinë e komuniteteve në Këshillin Komunal të Sigurisë në Bashkësi.</p>	<p>kuvendit të komunës.</p> <p>Jep informacione për punën e KK-së, NKK-së dhe ZKKK-së.</p> <p>ZKKKK e informon autoritetin mbikëqyrës, MAPL-në, për punën, sipas kërkesës për raportim.</p> <p>Raportimi mund të kryhet me shkrim dhe verbalisht.</p>
--	---	--	---

▪ **VLERËSIM I POZITËS SË ZËVENDËSKRYESUESIT TË KUVENDIT TË KOMUNËS PËR KOMUNITETE (ZKKKK)**

**Themelimi i pozitës së ZKKKK**

Megjithëse regjistrimi i popullsisë i vitit 2011<sup>56</sup> nuk konsiderohet shprehimisht si standard sipas të cilit kjo pozitë është e detyrueshme ose jo, sikundër dhe me pozitën e NKK-së, ky

<sup>56</sup> Raporti i regjistrimit të popullatës i vitit 2011 është në dispozicion në: <https://ask.rks-gov.net/en/kosovo-agency-of-statistics/social/population-and-housing-census>.



raport përdorë regjistrimin si bazë për të përcaktuar komunat ku posti i ZKXXX-së duhet të jetë i detyrueshëm. Kështu, numri i saktë i popullsisë është i paqartë në komunat që kanë ZKXXX por ku nuk është bërë regjistrimi: Leposaviq, Mitrovicë Veriore, Zubin Potok dhe Zveçan. Prandaj, njëloj si për NKK-në, janë përdorur vlerësimet e numrit të popullsisë nga Profilet Komunale të Misionit të OSBE-së në Kosovë të vitit 2018<sup>57</sup> për të vlerësuar pragun e dhjetë përqindëshit, në bazë të të cilit vetëm Mitrovica Veriore e kalon pragun e dhjetë përqindëshit. Sidoqoftë, pozita e ZKXXX-së është krijuar në Zubin Potok dhe Zveçan.

Duke përdorur vetëm regjistrimin e popullsisë si njësi matëse, ZKXXX-të janë të detyrueshëm në Dragash, Fushë Kosovë, Graçanicë, Kllokot, Novobërdë, Prizren dhe Shtërpçë. Derisa ZKXXX-të ishin aktive në të gjitha këto komuna në vitin 2019, pozita e ZKXXX-së për Fushë Kosovën ishte plotësuar vetëm pjesërisht pasi kishte qenë e zbrazët nga 28 marsi 2019 deri në fund të vitit. Për shkak se ka qëndruar e zbrazët për kohë të gjatë, kjo pozitë do të konsiderohet si e paplotësuar për qëllimet e këtij raporti. Në këtë vlerësim, të gjitha pozitat e ZKXXX-së konsiderohen së bashku, jo ndarazi si në pozitën e NKK, duke pasur parasysh se vetëm dy mund të bien jashtë rubrikës së dhjetë përqindëshit.

### **Statusi ligjor i pozitave të ZKXXX-ve jo të detyrueshëm**

Ndryshe nga pozita e NKK-së, në rastin e të cilëve edhe NKK-të jo të detyrueshëm tanimë njihen ligjërisht me udhëzimin e fundit administrativ të vitit 2020<sup>58</sup>, për pozitat jo të detyrueshme të ZKXXX-ve nuk ka ndonjë përkufizim ligjor. Ndërsa në segmentin për NKK pozitat e detyrueshme dhe ato jo të detyrueshme të këtij raporti vlerësohen veçmas, si ZKXXX i detyrueshëm ashtu edhe ai jo i detyrueshëm janë vendosur në të njëjtin grafik duke pasur parasysh se vetëm dy sosh konsiderohen jo të detyrueshëm.

ZKXXX, ashtu si NKK, është trajtuar në nenin 4 të *Udhëzimit administrativ nr. 2010 të MAPL-së për kufizimin e kompensimit dhe marrjes së pagesës nga zyrtarët e komunave* (nxjerrë më 10 mars 2010) ku përcaktohet shprehimisht që komunat të cilat e plotësojnë pragun e dhjetë përqindëshit kanë të drejtën për të pasur ZKXXX që pranon pagë. Nga kjo dispozitë shihet se ato komuna që nuk e plotësojnë pragun e dhjetë përqindëshit nuk kanë të drejtë të kenë ZKXXX me pagë, ndryshe nga komunat që e arrijnë këtë prag.

### **Përkatësia e komunitetit në pozitën e ZKXXX-së**

Kriteri për përkatësi të komuniteteve ndryshon nga ai për NKK-në, pasi pozitën e ZKXXX-së e mban cilido kandidat nga radhët e komuniteteve joshumicë i cili i ka marrë shumicën e votave në listën e hapur të kandidatëve për zgjedhje për kuvendin e komunës, që nuk do të thotë domosdoshmërisht të jetë nga radhët e komunitetit më të madh joshumicë. Sipas përkatësisë së komunitetit, pozitën e ZKXXX-së e mbanin shtatë shqiptarë të Kosovës<sup>59</sup>, një goran i Kosovës (Dragash) dhe një turk i Kosovës (Prizren). Kur krahasohet me regjistrimin e

<sup>57</sup> Raport i OSBE-së, *Përmbledhje e të gjitha profileve të komunave 2018*, (29 janar 2019) <https://www.osce.org/mission-in-kosovo/410279?download=true>

<sup>58</sup> Udhëzimi administrativ nr. 02/2020 për procedurën e emërimit të nënkryetarëve në komuna, (21 shtator 2020)

<sup>59</sup> Graçanicë, Kllokot, Mitrovicë e Veriut, Novobërdë, Shtërpçë. Zubin Potok, Zveçan.

popullsisë të vitit 2011, që përdoret në këtë raport për të vlerësuar kriterin prej dhjetë për qind për këtë pozitë dhe numrin e popullsisë nga radhët e komuniteteve për të përcaktuar se cili komunitet përbën apo nuk përbën komunitet joshumicë, vërehet se në tri komuna<sup>60</sup> që kanë përfaqësues shqiptarë të Kosovës, sipas regjistrimit të popullsisë të vitit 2011 këto janë komunitete shumicë, e jo joshumicë.

### **Vlerësim i përmbushjes së angazhimeve ligjore dhe të politikave nga ZKKKK**

Siç është vënë në dukje në komponentët e tjerë të vlerësimit të këtij raporti, pyetjet e paraqitura më poshtë janë marrë nga një anketë e përvitshme e realizuar me përfaqësuesit e secilit mekanizëm, ku përfaqësuesi, në këtë rast ZKKKK, u përgjigjet pyetjeve të cilat bazohen në aspektet kryesore të kornizës ligjore ose të politikave. Këto anketa plotësohen më tutje nga vëzhgimet e ekipeve të OSBE-së në terren. Të dhënat e këtij segmenti të shfaqura nëpër diagrame për secilën pyetje janë nga fundi i vitit 2019. I përvitshëm i OSBE-së drejtuar përfaqësuesve nga secila ZKKK, plotësuar pastaj me vrojtimit e ekipeve të OSBE-së në terren. Emrat e saktë të komunave që përmbushin ose nuk përmbushin zotimet për secilën pyetje në këtë segment mund të gjenden në shtojcën e këtij raporti, përveç segmenteve lidhur me raportimin dhe çështje që kanë të bëjnë me informimin në kohë për secilën komunë siç shpjegohen në kuadër të tekstit. Në mënyrë të ngjashme, pozita e vetme e lirë e ZKKKK-së në Fushë Kosovë, nuk është paraqitur në shtojcë.

### **Reportimi**

Nuk ka zotime për raportim as në kornizën ligjore e as në udhëzime, si dhe raportimi nuk ka strukturë formale dhe është lënë si mundësi fakultative verbale ose me shkrim. Pavarësisht nga rëndësia e pozitës së ZKKKK-së si person kontaktues dhe kontrollues kushtetues, pa ndonjë angazhim formal të raportimit, mbledhjes dhe evidentimit të çështjeve të vazhdueshme, transparenca themelore e tij është e penguar. Në mënyrë të ngjashme, ndryshe nga zotimet e raportimit të KK-së dhe ZKKK-së të cilat marrin shikueshmëri në të gjithë kuvendin komunal, ZKKKK merr më pak dukshmëri formale në mungesë të ndonjë formati të përcaktuar të raportimit. Në vitin 2019, vetëm ZKKKK në Shtërpçë ka komentuar se çdo vit ia transmeton kontributet e tij kryesuesit të kuvendit I i cili i inkorporon ato në një raport vjetor të kuvendit të komunës.

### **A ka hasur ZKKKK në ndonjë problem në marrjen e informacionit në kohë ose të plotë nga komuna ose kuvendi i komunës?<sup>61</sup>**

Në vitin 2019, dy ZKKKK diskutuan për problemet me marrjen e informacionit në kohë, ndonëse jo në raport me kuvendin e komunës. Një ZKKKK (Graçanicë) vuri në dukje mungesën e konsistencës në lidhje me mbledhjet dhe rendet e ditës të dërguara nga KK, tjetri (Novobërdë) deklaroi se merr informacion të pamjaftueshëm për aktivitetet e drejtorive komunale dhe ftesat për të marrë pjesë në mbledhje të komiteteve nuk janë pranuar gjithmonë. Ndërsa këto çështje janë shqetësuese, shumica e ZKKKK-ve nuk kanë raportuar


<sup>60</sup> Kllokot, Novobërdë, Shtërpçë.

<sup>61</sup> Kjo çështje bazohet në bashkëpunimin e NKK-së me mekanizmat e tjerë siç diskutohet në Udhëzimet përkatëse.

probleme. Të gjithë ZKXXX-të duket se kanë raporte të mira pune me kuvendet përkatëse komunale, gjë që është e rëndësishme për mandatin e tyre qendror si pikë kontakti midis komuniteteve dhe kuvendit.


**A ka promovuar ZKXXX dialogun ndërmjet komuniteteve?<sup>62</sup> (2 Po, 7 Jo, 1 pozitë e paplotësuar)**

Dialogu ndërmjet komuniteteve është një nga detyrat e pakta të përcaktuara në kornizën ligjore nën LVQL, që gjithashtu shtjellohet pak në Udhëzimet e vitit 2015 për ZKXXX-në. Ndërsa ZKXXX është pjesëtar i një komuniteti të caktuar, roli si i tillë mbështet si komunitetin nga i cili vjen ZKXXX ashtu edhe komunitetet tjera joshumicë dhe marrëdhëniet e tyre me komunitetin shumicë. Megjithatë, vetëm dy ZKXXX kishin dhënë shembuj konkretë të një avokimi të tillë (Kllokot, Zveçan). Në asnjë rast ZKXXX nuk ishte angazhuar në mënyrë specifike për përfshirjen më të madhe të komuniteteve në punën e kuvendit të komunës siç është paraparë në udhëzime.



**A i ka adresuar ZKXXX brengat dhe çështjet në lidhje me nevojat e komuniteteve në mbledhjet e kuvendit dhe në kuadër të punës së tij?<sup>63</sup> (6 Po, 3 Jo, 1 pozitë e paplotësuar)**

Mandati i avokimit për nevojat e komuniteteve në takimet e kuvendit të komunës rrjedh drejtpërsëdrejti nga Kushtetuta. Fatkeqësisht ky funksion thelbësor nuk po jetësohet në shumicën e komunave që kanë ZKXXX, por është një nga rolet më të rëndësishme që ky mekanizëm duhet ta përmbushë. Brengat që u ngritën në lidhje me nevojat e komuniteteve përfshinin përqendrimin në mbështetje në infrastrukturë, investime në zona të largëta të banuara nga komunitetet, ndërtim të shkollave fillore për të mbështetur arsimimin e komuniteteve dhe masa tjera të ngjashme në të mirë të komuniteteve.



**▪ PËRMBLEDHJE E GJETJEVE - ZËVENDËSKRYESUESI I KUVENDIT TË KOMUNËS PËR KOMUNITETE**

- Meqenëse korniza ligjore nuk ofron asnjë përkufizim ose rrugë ligjore për krijimin e ZKXXX-ve jo të detyrueshëm dhe në mënyrë të qartë ndalon pagat për këto pozita në rast se janë jo të detyrueshëm, krijimi i pozitave të ZKXXX jo të detyrueshëm duhet të merret në konsideratë. Duke e pasur parasysh mundësinë e tyre për të ngritur çështje në

<sup>62</sup> Ligji për VQL, neni 55, shënimi i mësipërm 7.

<sup>63</sup> Po aty.

Gjykatën Kushtetuese, këta mekanizma duhet të krijohen vetëm në rastet kur i kanë të drejtat e plota. Ndërsa këta mekanizma kanë treguar se mund të jenë avokues të rëndësishëm për komunitetet, mund të krijohet një rol i veçantë opsional i cili do t'u lejojë ZKKKK-ve jo të detyrueshëm të bëjnë punë të rëndësishme që nuk përfshijnë shqyrtimin kushtetues, duke ruajtur njëherazi karakterin e veçantë të ZKKKK në cilësi të detyrueshme. Përndryshe, ekziston nevoja për një rrugë të qartë ligjore për ZKKKK me të drejta të plota, aty ku ato janë jo të detyrueshme.

- Përkundër përkufizimit të tij kushtetues, mekanizmi i ZKKKK-së ka përkufizim shumë të ngushtë në legjislacionin ekzistues dhe nuk ka asnjë udhëzim të veçantë administrativ për të dhënë ndonjë hollësi përkritazi me detyrat e tij. Në mënyrë të ngjashme, në kuadër të kornizës së politikave nuk janë paraparë kritere për takime apo raportime periodike për këtë mekanizëm dhe kështu ka më pak standarde thelbësore të performancës. Derisa mandati i tij thelbësor për të vëzhguar shkeljen kushtetuese për komunitetet mbetet detyra e tij më e rëndësishme e përcaktuar me kushtetutë, ky mekanizëm do të përfitonte nga përkufizimi më i gjerë mbi rolin që e luan.
- Ndryshe nga NKK, nuk ka asnjë masë ligjore që përcakton për sa kohë lejohet të mbetet boshe kjo pozitë. Duke qenë se kjo pozitë supozohet të veprojë si vëzhgues i të drejtave të njeriut me mundësi për të informuar drejtpërdrejt Gjykatën Kushtetuese për shkeljet me të cilat përballen komunitetet joshumicë, duhet të miratohen masa kundër lënies së zbrazët të kësaj pozite. Në vitin 2019, pozitat e zbrazëta veç i kishin prekur komunitetet në një komunë, duke dobësuar përfaqësimin politik dhe mbrojtjen e tyre.
- Duke qenë se puna e tij është drejtpërsëdrejti brenda kuvendit të komunës, një theks më i madh në rolin e paraparë me kornizë të politikave si pikë zyrtare kontakti për shqetësimet e komuniteteve, dhe bashkëpunimin në mbajtjen e takimeve publike dhe konsultimeve me komunitetet dhe publikun, do të mund t'i avanconte detyrat e tij themelore. Kjo do të ishte veçanërisht e dobishme në kontekst të rregullimit ekzistues, siç janë standardet e transparencës dhe standardet minimale të konsultimit publik,<sup>64</sup> dhe mund të ndihmojë gjithashtu potencialisht në forcimin e përpjekjeve të rëndësishme në dialogun ndërmjet komuniteteve dhe përfshirjen kuptimplotë të komuniteteve në planet dhe strategjitë komunale të veprimit.

## ANALIZA GJINORE

Të drejtat e grave për pjesëmarrje të barabartë në organet ekzekutive janë përforcuar në kornizën ligjore përmes Ligjit të vitit 2015 për barazinë gjinore, i cili thotë

---


<sup>64</sup> UA nr. 03/2020 për transparencën në komuna (25 shtator 2020). UA nr. 06/2018 për standardet minimale të konsultimit publik nëpër komuna (31 dhjetor 2018).

“[o]rganet legjislative, ekzekutive dhe gjyqësore në të gjitha nivelet, si dhe institucionet tjera publike, janë të obliguara të miratojnë dhe zbatojnë masa të veçanta për të arritur përfaqësimin e gjinisë më pak të përfaqësuar, deri në arritjen e përfaqësimit të barabartë të femrave dhe meshkujve sipas këtij ligji.” Neni 6.8 i këtij ligji thotë se "përfaqësimi i barabartë gjinor në të gjitha organet legjislative, ekzekutive dhe gjyqësore dhe institucionet e tjera publike arrihet kur sigurohet përfaqësim minimal prej pesëdhjetë për qind (50%) për secilën gjini, përfshirë edhe organet e tyre drejtuese dhe vendimmarrëse.”<sup>65</sup>

Në periudhën e vlerësuar, disa përmirësime të konsiderueshme mund të shihen në KK, megjithatë në tre mekanizmat e tjerë është vërejtur përparim i pakët. Në mënyrë të ngjashme, përcaktimi me Ligjin për barazinë gjinore për arritje të përfaqësimit prej pesëdhjetë për qind nuk po plotësohet nga asnjëri prej katër mekanizmave. Në nivel të mekanizmit, përveç përmirësimit më të spikatur, dhjetë KK kanë arritur të kenë përfaqësim prej pesëdhjetë për qind ose më shumë të grave, gjë që është zhvillim pozitiv. Mirëpo, më pak se pesëdhjetë për qind e të gjitha KK-ve kanë arritur përfaqësim të ekuilibruar gjinor.

### Komiteti për Komunitete

Në vitin 2017, gratë mbanin 90 pozita në KK, pak më pak se një e treta (31,14 për qind), kurse burrat 199 pozita (68,86 për qind). Në vitin 2019, numri i grave të përfaqësuar u rrit konsiderueshëm, në 119 (41,90 për qind), kurse numri i burrave ra nga 199 në 165 (58,10 për qind). Pati një përmirësim të dukshëm në përfaqësimin e grave nga viti 2017 në vitin 2019 - një rritje prej 10.76 për qind - megjithatë, kjo ende nuk e arrin 50 përqindëshin për përfaqësim të barabartë ashtu siç parashihet me Ligjin për barazinë gjinore.




<sup>65</sup> Ligji nr. 05/L-20 për barazinë gjinore, 26 qershor 2015.

Në vitin 2017, ishin pesë komuna ku burrat përbënin 100 për qind të pozitive të KK (Gjilan, Junik, Mamushë, Viti dhe Zubin Potok), gjersa nuk kishte asnjë komunë ku gratë mbanin 100 për qind të pozitive. Mirëpo, në vitin 2019, nuk kishte komuna ku burrat mbanin 100 për qind të pozitive, gjë që tregonte se gratë tani përfaqësohen në KK të çdo komune.

Në vitin 2017, ishin vetëm shtatë komuna ku gratë mbanin të paktën 50 për qind të pozitive të KK (Kaçanik, Hani i Elezit, Shtërpçë, Glllogoc, Zveçan, Mitrovicë Veriore dhe Gjakovë). Në vitin 2019, ishin dhjetë komuna ku gratë përfaqësonin të paktën 50 për qind të pozitive të KK (Kaçanik, Kamenicë, Partesh, Shtërpçë, Mitrovicë Veriore, Podujevë, Gjakovë, Fushë Kosovë, Malishevë dhe Mamushë). Kjo tregon për një përmirësim nga viti 2017, megjithatë, mbeten 28 komuna që nuk plotësojnë përfaqësimin e barabartë gjinor.

### Zyra Komunale për Komunitete dhe Kthim

Në vitin 2017, burrat mbanin 114 nga 164 pozita në ZKKK (69.52 për qind), kurse gratë mbanin 50 pozita (30.48 për qind). Në vitin 2019, burrat kishin 111 nga 160 pozita (69,38 për qind), gratë kishin 49 (30,62 për qind). Baraspesha gjinore e ZKKK mbetet praktikisht e pandryshuar mes viteve 2017 dhe 2019.<sup>66</sup>




Në vitin 2017, dhjetë ZKKK ishin të përbëra 100 për qind nga burrat (Kaçanik, Hani i Elezit, Viti, Shtërpçë, Podujevë, Zveçan, Leposaviq, Suharekë, Mamushë dhe Dragash), dhe ky numër u rrit në 13 në vitin 2019 (dhjetë komunat e mëparshme plus Shtime, Partesh dhe Junik). Ndonëse nuk pritet që të pësojnë ndryshime të mëdha për dy vjet si mekanizma të përbërë nga nëpunës civilë dhe jo përfaqësues të zgjedhur, ata duhet të vazhdojnë që të merren parasysh për zhvillimin e ardhshëm të këtij mekanizmi.

<sup>66</sup> Kjo pjesë merr parasysh të gjitha ZKKK-të si dhe Zyrat Komunale të Komunitetit në Leposaviq, Mitrovicë Veriore dhe Zubin Potok.

Duhet theksuar se në vitin 2017, gratë përbënin 100 për qind të ZKKK-ve në katër komuna (Kllokot, Gllogoc, Mitrovicë Veriore dhe Malishevë). Sidoqoftë, në që të katër rastet, ZKKK përbëhej nga një grua. Në vitin 2019, gratë përbënin 100 për qind të ZKKK-ve në po të njëjtat katër komuna dhe, përsëri, këto ZKKK përbëheshin nga vetëm një grua.

### Nënkryetari i Komunës për Komunitete dhe Zëvendëskryesuesi i Kuvendit të Komunës për Komunitete



Kjo pjesën numëron të gjithë NKK-të dhe ZKKKK-të pavarësisht nëse konsiderohen të pozita të detyrueshme apo jo. Ndërsa këta mekanizma janë të ngjashëm pasi që të dy mbahen nga një person, ata dallojnë për nga kriteret e tyre të përzgjedhjes. NKK-të, të cilët duhet të miratohen nga kuvendi i komunës, së pari nominohen nga kryetarët e komunave. Duke pasur parasysh që gratë përfaqësoheshin vetëm në tre pozita të NKK, ndërsa dhjetë pozitat e tjera ishin të zëna nga burrat, barra për mungesën e përfaqësimit të grave bie mbi kryetarët e komunave të cilët duhet t'i marrin parasysh gratë më shpesh në nominimet e tyre. Duke pasur parasysh që pozita e ZKKKK-së varet nga ajo se cili kandidat nga komunitetet joshumicë merr më së shumti vota në zgjedhjet për kuvend të komunës, përfaqësimi i grave varet më shumë nga përfshirja e grave në politikë dhe pranimi i tyre për ta bërë një gjë të tillë në kuadër të komunave. Në vitin 2019, që të nëntë pozitat e ZKKKK mbaheshin nga burrat<sup>67</sup>, gjë që dëshmon se ky mekanizëm ka shkallën më të ulët të përfshirjes së grave.

<sup>67</sup> Dragash, Graçanicë, Kllokot, Mitrovicë Veriore, Novobërdë, Prizren, Shtërpçë, Zubin Potok dhe Zveçan.

## KONSTATIME

Duke mbajtur parasysh përmbledhjen e gjetjeve, gjetjet e veçanta për mekanizmat dhe kornizat përkatëse ligjore dhe të politikave të secilit mekanizëm, në që të katër mekanizmat është shënuar përparim modest por i pabarabartë dhe i pamjaftueshëm. Në raportin e OSBE-së të vitit 2014 me titull *“Vlerësim i mekanizmave të nivelit lokal për mbrojtjen dhe promovimin e të drejtave dhe interesave të komuniteteve në Kosovë”*, ku u vlerësuan të njëjtët mekanizma si në këtë raport, u konstatua se:

Zbrazëtitë e konsiderueshme në kuadrin ligjor ndikojnë negativisht në aftësinë e institucioneve të Kosovës për të promovuar dhe mbrojtur të drejtat dhe interesat e komuniteteve në përputhje me standardet ndërkombëtare. Mungesa e akteve të detajuara nënligjore për Ligjin për vetëqeverisje lokale i ka lënë vendimmarrësit dhe palët e interesit në mungesë të udhëzimeve të sakta për çështjet praktike të veprimtarisë dhe funksionimit të tre nga katër mekanizmat. Gjersa hartimi i dokumenteve të politikave ofron udhëzime shtesë për punën e KK-ve, ato nuk e kanë fuqinë e legjislacionit. Prandaj, inkorporimi i elementeve kyçe të atyre udhëzimeve të politikave në akte nënligjore do të jetë vendimtar për të siguruar funksionimin efektiv të mekanizmave dhe përputhshmërinë e tyre me kuadrin ligjor.<sup>68</sup>

Përkundër asaj se këto konstatime janë hartuar gati gjashtë vjet më parë, ky vlerësim mbetet kryesisht relevant. Pjesë të shumta të legjislacionit dytësor për LVQL-në kanë hyrë në fuqi që nga publikimi i raportit të mëparshëm dhe fundi i vitit 2019, ndonëse shumë prej tyre nuk kanë përmbajtur detyra themelore të drejtpërdrejta dhe me mandat qartë për këta mekanizma që lidhen me komunitetet. Ndërsa për KK-të është dhënë një përkufizim ligjor me anë të rregullores për propozimin e akteve normative komunale dhe ndryshimin e plotësimin e udhëzimit administrativ për komitetet e përhershme në komuna, mekanizmi pritet që të lartësojë detyrat e rëndësishme nga korniza e politikave në grupin e tij të detyrimeve ligjore. Përmirësimi i kornizës ligjore është i rëndësishëm për koherencën e këtyre mekanizmave dhe gjithashtu mund të mbështesë detyrat e kornizës së politikave të

---

<sup>68</sup> Vlerësim i mekanizmave të nivelit lokal për mbrojtjen dhe promovimin e të drejtave dhe interesave të komuniteteve në Kosovë, f. 30, qershor 2014, <https://www.osce.org/kosovo/120343?download=true>



tilla si shqyrtimi i politikave ose buxhetit, e që pjesërisht varen nga akterë të tjerë të nivelit komunal.

Megjithëse Udhëzimi administrativ i vitit 2014 për zgjedhjen e nënkryetarëve të komunave ishte një sukses i veçantë në këtë drejtim, vendimi i ministrit të Administrimit të Pushtetit Lokal për shfuqizimin e Udhëzimit administrativ në shtator të vitit 2019 e dëmton përparimin e kufizuar që është shënuar në kornizën ligjore. Udhëzimet e vitit 2015 për ZKKKK-në janë një masë e lavdërueshme për të ndihmuar për përkufizimin e këtij mekaniizmi, megjithatë legjislacioni dytësor mungon tërësisht për këtë mekaniizëm në veçanti. Kornizat e politikave kanë qenë të rëndësishme për të ndihmuar zhvillimin e këtyre mekaniizmave dhe institucionet qeveritare duhet të krijojnë modele të standardizuara për projekte, raporte dhe të ngjashme. Modelet e tilla janë përpiluar tashmë për KK-në, siç u shtjellua në kapitullin gjegjë, dhe hartimi i dokumenteve të ngjashme për mekaniizmat e tjerë do të ishte i dobishëm. Kjo është veçanërisht e rëndësishme për ZKKKK-në, që vazhdon të jetë mekaniizmi më i rëndësishëm në punën e rregullt dhe projektet që prekin komunitetet, megjithatë, ajo nuk është e fuqizuar me mjetet e standardizuara për të realizuar mandatin e saj.

Përkundër mangësive në kornizën ligjore, këta mekaniizma kanë dëshmuar se mund të jenë përkrahës të rëndësishëm për komunat ku ata janë funksionalë dhe kanë prodhuar rezultate të qarta përmbajtësore në dobi të komuniteteve të cilave u shërbejnë. Krijimi i pozitive të tilla në pothuajse tërë Kosovën mbetet një arritje e rëndësishme, ashtu si dhe kategoritë e zgjedhura që patën avancime të konsiderueshme. Në veçanti ZKKKK-ja ka arritur që të bëjë hapa të rëndësishëm në shumicën e zyrave duke zbatuar detyrat e përcaktuara me ligj, megjithatë, ngjashëm me mekaniizmat e tjerë, ndërsa ato mund të konsiderohen se kanë përmbushur aspektet minimale të kornizës ligjore, ato kanë rezultate shumë më pak të favorshme në krahasim me aspektet më ambicioze të kornizave të politikave të tyre. NKK, e deri diku edhe ZKKKK, kanë dëshmuar se janë integruar mjaft mirë në strukturën vendimmarrëse të komunave në mbarë Kosovën. Ndërsa ato mund të përfitojnë nga detyrat që janë të përkufizuara më mirë, rezultatet e tyre në përgjithësi kanë realizuar aspektet më të rëndësishme të kornizave të tyre ligjore dhe të politikave, gjë që është një arritje e rëndësishme.

Zhvillimi jo i duhur i kornizës ligjore është një pengesë e madhe për këta mekaniizma, siç është ndonjëherë edhe mungesa e nismës nga vetë këta mekaniizma. Përpjekjet e bashkërenduara për të tejkaluar sfidat e identifikuara në këtë raport dhe rekomandimet në pjesën vijuese mund t'u ndihmojnë këtyre mekaniizmave që të realizojnë potencialin e tyre të plotë. Përfundimisht, mirëqenia dhe të drejtat e njeriut të komuniteteve joshumicë në Kosovë vazhdojnë të mbesin kryesisht barrë e këtyre mekaniizmave dhe si rrjedhim mbështetja nga të gjitha palët e interesit për trajektoren e tyre pozitive mbetet shumë e rëndësishme.

## REKOMANDIME

Për institucionet përkatëse qeveritare, përfshirë Ministrinë e Administrimit të Pushtetit Lokal, Ministrinë për Komunitete dhe Kthim dhe Zyrën për Çështje të Komuniteteve:

- 1. Të hartohet legjislacioni dytësor për Zëvendëskryesuesin e Kuvendit të komunës për Komunitete.** Si mekanizëm i përkufizuar me kushtetutë, për ZKKKK-në ende nuk ka legjislacion dytësor që kurse është themeluar. Kjo duhet të azhurnohet për të plotësuar nevojat e komuniteteve joshumicë dhe të kësaj zyre.
  1. Si pikë e përkufizuar e kontaktit dhe e ndërveprimit të komuniteteve në kuvendin komunal, një rregullore për ZKKKK-në mund ta pozicionojë zyrtarisht ZKKKK-në si lehtësues të angazhimit të komuniteteve për të mbështetur legjislacionin e fundit për standardet minimale të konsultimit publik në komuna. Me dispozitat e veçanta në nenet 14 dhe 19 për identifikimin e palëve të interesit dhe për përfshirjen e tyre në grupet e punës, ZKKKK është një kanal i pozicionuar mirë për ta lehtësuar këtë në emër të komuniteteve.<sup>69</sup> Në mënyrë të ngjashme, ZKKKK është në pozitë të mirë për të siguruar përfshirjen e komuniteteve në takimet e detyrueshme me banorët siç përcaktohet në legjislacionin më të fundit për transparencën në komuna.<sup>70</sup>
- 2. Të konsolidohet profili i Komitetit për Komunitete.** KK mbetet një nga dy komitetet e përhershme në të gjitha komunat, megjithatë, në praktikë ai nuk e ka forcën institucionale të komitetit për politika dhe financa, megjithëse ka peshën ligjore të barasvlershme. Duhet të ndërmerren masa konkrete për të baraspeshuar pozitën e KK në strukturën komunale e që mund të përfshijë:
  1. Një udhëzim administrativ të hartuar enkas për t'i siguruar KK-së mundësinë e shqyrtimit të detyrueshëm gjatë miratimit të politikave, akteve dhe buxhetit komunal të komunës. Derisa KK ka detyrim të përcaktuar shprehimisht që të shqyrtojë të gjitha aktet, politikat dhe aktivitetet e komunës, kjo nuk po ndodhë në masë të madhe. Ndonëse KK-të janë përgjegjëse që të ndërmarrin nisma për përmbushjen e mandatit të tyre, ato duhet të kenë peshën e duhur ligjore që të mos anashkalojnë nga komuna dhe të fuqizohen që ta përmbushin mandatin e tyre thelbësor për shqyrtim dhe dhënie të rekomandimeve.
- 3. Të konsolidohet Zyra Komunale për Komunitete dhe Kthim për mbështetjen e komuniteteve të cilat nuk janë të kthyer.** Ndonëse rregullorja e vitit 2010 për krijimin e ZKKK përmban më së shumti hollësi për sa u përket mekanizmave të vlerësuar në këtë raport, mund të bëhet më shumë duke pasur parasysh detyrat shtruese sipas kornizës së politikave e që nuk përcaktohen me anë të ligjit. Gjersa

<sup>69</sup> UA nr. 06/2018 për standardet minimale të konsultimit publik në komuna (31 dhjetor 2018).

<sup>70</sup> UA nr. 03/2020 për transparencën në komuna (25 shtator 2020).

në vitin 2018, sipas kornizës së portofolit për kthim, ZKKK-së iu dhanë udhëzime të konsiderueshme përmes Rregullores nr. 01/2018 të MKK-së për kthimin e personave të zhvendosur dhe zgjidhje të qëndrueshme, ende nuk ka ekuivalent ligjor që prekë komunitetet të cilat nuk janë të kthyer. Avancimi i angazhimeve dhe rolit të ZKKK-së me komunitetet mund të përfshijë:

1. Promovimi i një dokumenti për komunitetet të barasvlershëm me planin e veprimit për kthim në udhëzimin ekzistues administrativ do të ishte një masë e dobishme në këtë drejtim, duke marrë parasysh sa shpesh ceken planet e veprimit në kornizën e politikave. Njëkohësisht, planet e obligueshme të veprimit mund të përfshijnë një ngritje të vlerësimit të nevojave nga korniza e politikave në kornizën ligjore. Vlerësimi i nevojave është një mjet thelbësor për të siguruar rëndësinë e punës së ZKKK-së dhe për t'iu përshtatur nevojave në ndryshim e sipër të komuniteteve në një komunë.
  2. Hartimi i udhëzimeve për ZKKK. Një doracak për zbatim, veçanërisht me theks të shtuar për menaxhimin e projektit dhe formularë standard, do të ishte i dobishëm për këto zyra që t'i zhvillojnë projektet e tyre dhe të krijojnë partneritete më të mira strategjike me OJQ-të në terren. Aktualisht, KK ka udhëzimet që mund të kopjohen për ZKKK-të dhe të shërbejnë si një doracak i praktikave më të mira.
- 4. Të konsolidohen rezultatet konkrete, bashkëpunimi dhe format e takimeve në nivelin ligjor.** Përveç rekomandimeve të veçanta për secilin mekanizëm, standardet e performancës siç janë afatet kohore të raportimit, afatet vjetore të dorëzimit të raporteve, format e takimit me palët përkatëse të interesit ose prezantimi para kuvendit të komunës, përgjithësisht nuk janë dhe aq të qartësuara për që të gjithë mekanizmat e vlerësuar në këtë raport. Këtu duhet të përfshihet edhe rishikimi i kornizave të politikave, duke i ngritur kriteret e tilla ekzistuese dhe tashmë pjesërisht të zbatuara. Avancimi i këtyre detyrave të zyrtarizuara ndihmon për mbështetjen e karakterit institucional të këtyre mekanizmave, transparencën e tyre dhe aftësinë e tyre për t'u rishikuar në mënyrë kuptimplote në nivelin e qeverisë.
- 5. Të avokohet për barazi më të madhe gjinore.** Siç dëshmohet nga rezultatet nga të dyja grupet e të dhënave nga viti 2017 dhe 2019 të paraqitura në këtë raport, është shënuar shumë pak përparim sa i përket barazisë gjinore në këta mekanizma. Për të patur përparim domethënës në këtë fushë, mund të jetë e dobishme që të konsiderohen masa për ta përfshirë shprehimisht këtë në legjislacion ose akte nënligjore, jo vetëm në Ligjin gjithëpërfshirës për barazinë gjinore<sup>71</sup>. Shembull i lavdërueshëm në këtë drejtim ka qenë përmirësimi i kornizës ligjore të KK-së, që me udhëzimin më të fundit administrativ për përbërjen dhe detyrat shprehimisht forcon barazinë gjinore në përbërjen e tij dhe kriteret për zgjedhjen e anëtarëve.<sup>72</sup>

<sup>71</sup> Ligji nr. 05 / L-20 për barazi gjinore, 26 qershor 2015.

<sup>72</sup> UA nr. 05/2020 për procedurën e themelimit, përbërjen dhe kompetencat e komiteteve të përhershme dhe komiteteve të tjera në komunë (21 dhjetor 2020).

- 6. Të zgjidhet statusi i ZKXXX-ve të detyrueshëm.** Pragu prej dhjetë për qind mbetet i pakapshëm në mungesë të një matje ose metode të qartë për përcaktimin e këtij numri të popullsisë dhe rasteve të shumta të këtyre mekanizmave ku ata nuk përcaktohen në mënyrë të qartë në ligj. Megjithatë, siç kanë dëshmuar gjetjet e këtij raporti, ZKXXX-të janë avokues të rëndësishëm për komunitetet dhe, kështu, një rrugëzgjdhje mund të jetë që të kenë një rol alternativ opsional që mund të zgjidhet nga komunat. Kjo do të ruante karakterin unik juridik të ZKXXX-së dhe njëherësh të inkurajonte dhe t'u jepte mundësi komunave që duan të bëjnë më shumë për komunitetet joshumicë. Ky ka qenë problem i vazhdueshëm me NKK-të deri në miratimin e *Udhëzimit administrativ nr. 02/2020 për procedurën e emërimit të nënkryetarëve të komunave*<sup>73</sup>, që i dha qartësi zyrtare pozitës në rastet kur emërimi nuk është i detyrueshëm. Ndërsa kjo masë është jashtë periudhës kohore të vlerësimit për këtë raport, ajo është pjesë e rëndësishme e legjislacionit dytësor dhe ZKXXX do të përfitonte gjithsesi nga një qartësi e ngjashme ligjore, dhe nënvizon edhe më rekomandimin e dytë të këtij raporti për nevojën për legjislacion dytësor për ZKXXX.
- 7. Të ketë qëndrim të vendosur për pozitave e zbrazëta.** Institucionet qeveritare kanë rol tejet të rëndësishëm karshi plotësimit të pozitave në kundërshtim me ligjin sa i përket NKK. Në mënyrë të ngjashme, kërkesat ligjore për plotësimin e pozitave të zbrazëta duhet të ngriten për pozitën e ZKXXX-së, veçanërisht duke pasur parasysh karakterin kushtetues dhe problematikat e lidhura me pozitave e zbrazëta që janë ilustruar në këtë raport. Mosplotësimi i pozitave të zbrazëta vazhdon të minojë këta mekanizma dhe, si i tillë, është vërejtur në periudhën më të fundit të raportimit dhe ka qenë problem për një kohë shumë të gjatë.
- 8. Të bëhet raportim periodik për këta mekanizma.** Me përparimin e shënuar në ligj në lidhje me sistemin e menaxhimit të performancës së komunave, kjo duhet të mundësohet për të bërë një vlerësim të përvitshëm për statusin e këtyre mekanizmave. Me kontributet nga raportet e detyrueshme vjetore ose vendosjen e kriterëve për raportim obligativ vjetor, rishikimi nga ana e qeverisë mund të ndihmojë në ushtrimin e presionit aty ku është e nevojshme, si dhe identifikimin e sfidave specifike në mënyrë që të orientohen burimet e trajnimit dhe të ndërtimit të kapaciteteve për adresimin e tyre.
- 9. Të jenë të qasshme dokumentet e kornizës të politikave.** Përkundër rolit të tyre të konsiderueshëm në funksionalitetin e tanishëm të këtyre mekanizmave, asnjë nga dokumentet e kornizës së politikave nuk janë të qasshme në internet. Kjo mund të bëhet menjëherë dhe është masë e lehtë për të rritur transparencën.

---

<sup>73</sup> Udhëzimi administrativ nr. 02/2020 për procedurën e emërimit të nënkryetarëve në komuna (21 shtator 2020).

Për komunat, përfshirë udhëheqjen komunale dhe kuvendin e komunës, Komitetet për Komunitete, Nënkryetarin e Komunës për Komunitete, Zëvendëskryesuesin e Kuvendit Komunal për Komunitete dhe Zyrat Komunale për Komunitete dhe Kthim:

- 1. Të angazhohen komunitetet në procesin e përpilimit të buxhetit të komunës.** Me një theks të veçantë në aktivitetet konkrete, planet e punës dhe projektet, buxheti komunal është shumë i rëndësishëm për komunitetet dhe efikasitetin e këtyre mekanizmave. Meqenëse kjo është e rëndësishme për të gjithë mekanizmat dhe aktualisht merr pak vëmendje në shumicën e komunave, angazhimi dhe mundësimi më i madh përmes buxhetit është çelës kryesor i ndihmës së suksesshme për komunitetet.
- 2. Të vihet theks më i madh në aspektin gjinor gjatë përzgjedhjes.** Duke qenë se emërimi dhe përbërja është përgjegjësi e administratave komunale, duhet bërë më shumë për të barazi gjinore në mesin e përfaqësuesve dhe të emëruarve. Duke pasur parasysh përparimin e dobët përveçse në komitetet për komunitete, shqetësimet unike të grave dhe vajzave kanë nevojë për më shumë zë në nivelin komunal.
- 3. Të shtyhet para zyrtarizimi i procedurave.** Gjersa mund të jenë efektive në afat të shkurtër, rrjetet joformale të raportimit dhe takimeve, të cilat zhvillohen jashtë kornizave ligjore ose të politikave, përfundimisht e pengojnë aftësinë që këta mekanizma të përdoren ashtu siç janë synuar. Zyrtarizimi i procedurave e jetëson karakterin institucional të këtyre zyrave dhe roleve, si dhe përmbush angazhimet e rëna dakord në mënyrë tërësore dhe transparente. Ndonëse kjo nuk shkurajon aspektet joformale të punës dhe angazhimit të komunitetit, procedura joformale duhet të plotësojë e jo ta zëvendësojë raportimin zyrtar.
- 4. Të kërkohet në mënyrë proaktive angazhimi i komuniteteve.** Me rregulloren ekzistuese për angazhimin publik, t'i jepni përparësi komuniteteve në të gjithë institucionet komunale dhe të angazhoni në mënyrë proaktive mekanizmat me komunitetet në fushën e tyre. Kjo mund të përmirësohet nga ligjet që rregullojnë këto mekanizma, por nuk ka pengesa për të shënuar përparim më të madh për arritjen e kësaj.
- 5. Të ndihmohet për institucionalizimin e këtyre mekanizmave atje ku është e nevojshme.** Krijimi në masë të gjerë dhe funksionimi i mekanizmave ka qenë një arritje e rëndësishme, por në shumë raste mekanizmat nuk janë krijuar zyrtarisht dhe nuk funksionojnë sipas ligjit. Kjo është identifikuar me mosnjohjen e ZKKK-ve në statutet komunale dhe, për më tepër, vetë komunat duhet t'i kenë si prioritet pozitativ e detyrueshme të paplotësuara.

- 6. Të punohet me një qasje mbarëkomunale.** Secili mekanizëm në këtë raport ka një nivel të caktuar të angazhimit me kryetarin e komunës dhe komponentët e drejtorive komunale. Takimet për të përmirësuar marrëdhëniet e mira midis udhëheqjes komunale janë të rëndësishme dhe gjithashtu shfrytëzojnë pushtetin e thirrjes së takimeve të zyrës së kryetarit të komunës për të nxitur marrëdhënie të mira midis këtyre mekanizmave, të cilët duhet të punojnë së bashku për të promovuar në mënyrë efektive komunitetet duke pasur parasysh shpërndarjen e tyre mes degës legislative dhe asaj ekzekutive të komunës.

## SHTOJCA – MEKANIZMAT SIPAS KOMUNËS

Kjo pjesë e raportit paraqet zbërthimin e komunave që përmbushin detyrimet e tyre ligjore dhe të kornizës së politikave në vitin 2017 dhe 2019, sipas pyetjeve që janë parashtruar në këtë raport.

### **A është themeluar Komiteti i Komuniteteve siç duhet në përputhje me legjislacionin/rregulloren/ rezultatet e regjistrimit të popullsisë të vitit 2011?**

#### **2017**

Po: Ferizaj, Fushë Kosovë, Graçanicë, Istog, Junik, Kaçanik, Klllokot, Leposaviq, Lipjan, Mamushë, Partesh, Prishtinë, Prizren, Rahovec, Shtime, Skenderaj, Shtërpçë, Vushtrri, Zubin Potok dhe Zveçan.

Jo: Deçan, Dragash, Gjakovë, Gjilan, Glllogoc, Hani i Elezit, Kamenicë, Klinë, Malishevë, Mitrovicë Veriore, Mitrovicë Jugore, Novobërdë, Obiliq, Pejë, Podujevë, Ranillug, Suharekë dhe Viti.

#### **2019**

Po: Dragash, Ferizaj, Fushë Kosovë, Glllogoc, Leposaviq, Lipjan, Malishevë, Mamushë, Mitrovicë Veriore, Mitrovicë Jugore, Prishtinë, Ranillug, Skenderaj, Suharekë, Viti, Vushtrri, Zubin Potok dhe

Zveçan.

Jo: Deçan, Gjakovë, Gjilan, Graçanicë, Hani i Elezit, Istog, Junik, Kaçanik, Kamenicë, Klinë, Klllokot, Novobërdë, Obiliq, Pejë, Podujevë, Prizren, Rahovec, Shtime dhe Shtërpçë.

### **A është hartuar dhe miratuar plani i punës apo plani i aktiviteteve për KK?**

#### **2017**

Po: Ferizaj, Gjilan, Glllogoc, Graçanicë, Hani i Elezit, Istog, Kamenicë, Kaçanik, Klinë, Klllokot, Leposaviq, Lipjan, Malishevë, Mitrovicë Veriore, Mitrovicë Jugore, Obiliq, Partesh, Pejë, Podujevë, Prishtinë, Rahovec, Ranillug, Shtime, Skenderaj, Viti, Shtërpçë, Vushtrri.

Jo: Deçan, Dragash, Fushë Kosovë, Gjakovë, Junik, Mamushë, Novobërdë, Prizren, Suharekë, Zubin Potok, Zveçan.

## 2019

Po: Deçan, Dragash, Ferizaj, Fushë Kosovë, Graçanicë, Hani i Elezit, Istog, Junik, Kamenicë, Kaçanik, Klinë, Leposaviq, Lipjan, Malishevë, Mamushë, Novobërdë, Obiliq, Partesh, Pejë, Podujevë, Prishtinë, Prizren, Rahovec, Shtime, Skenderaj, Suharekë, Viti, Vushtrri.

Jo: Gllogoc, Gjakovë, Gjilan, Klllokot, Mitrovicë Veriore, Mitrovicë Jugore, Ranillug, Shtërpçë, Zubin Potok, Zveçan.

## A ka raportuar KK çdo gjashtë muaj në Kuvendin Komunal për punën e tij?

### 2017

Po: Kaçanik, Klinë, Hani i Elezit, Istog, Mitrovicë Veriore, Pejë, Prishtinë, Skenderaj, Shtime.

Jo: Deçan, Dragash, Ferizaj, Fushë Kosovë, Gjakovë, Gjilan, Gllogoc, Graçanicë, Junik, Kamenicë, Klllokot, Leposaviq, Lipjan, Malishevë, Mamushë, Mitrovicë Jugore, Novobërdë, Obiliq, Partesh, Podujevë, Prizren, Rahovec, Ranillug, Suharekë, Viti, Vushtrri, Zubin Potok, Zveçan, Shtërpçë.

### 2019

Po: Gjakovë, Istog dhe Prishtinë.

Jo: Deçan, Dragash, Ferizaj, Fushë Kosovë, Gjilan, Gllogoc, Graçanicë, Hani i Elezit, Junik, Kaçanik, Kamenicë, Klinë, Klllokot, Leposaviq, Lipjan, Malishevë, Mamushë, Mitrovicë Veriore, Mitrovicë Jugore, Novobërdë, Obiliq, Partesh, Pejë, Podujevë, Prizren, Rahovec, Ranillug, Shtime, Skenderaj, Shtërpçë, Suharekë, Viti, Vushtrri, Zubin Potok dhe Zveçan.

## A ka nxjerrë KK një raport vjetor me shkrim? Nëse jo, a ka ndonjë plan/angazhim të veçantë për raportimin?

### 2017

Po: Hani i Elezit, Kaçanik, Malishevë, Mitrovicë Veriore, Prizren, Rahovec, Skenderaj dhe Zveçan.

Jo: Deçan, Dragash, Ferizaj, Fushë Kosovë, Gjakovë, Gjilan, Gllogoc, Graçanicë, Istog, Junik, Kamenicë, Klinë, Klllokot, Leposaviq, Lipjan, Mamushë, Novobërdë, Obiliq, Partesh, Pejë, Podujevë, Prishtinë, Ranillug, Shtime, Shtërpçë, Suharekë, Viti, Vushtrri, Zubin Potok, Zveçan.

### 2019

Po: Ferizaj, Gjakovë, Graçanicë, Istog, Kamenicë, Lipjan, Mitrovicë Veriore, Mitrovicë Jugore, Obiliq, Pejë, Podujevë, Prishtinë, Prizren dhe Shtime.

Jo: Deçan, Dragash, Fushë Kosovë, Gjilan, Gllogoc, Hani i Elezit, Junik, Kaçanik, Klinë, Klllokot, Leposaviq, Malishevë, Mamushë, Novobërdë, Partesh, Rahovec, Ranillug, Skenderaj, Shtërpçë, Suharekë, Viti, Vushtrri, Zubin Potok dhe Zveçan.

## A ka nxjerrë KK rekomandime mbi çështje të veçanta në lidhje me mbrojtjen/promovimin e të drejtave të komunitetit për organet komunale?

### 2017

Po: Deçan, Ferizaj, Gjakovë, Gllogoc, Graçanicë, Kamenicë, Klinë, Leposaviq, Lipjan, Mitrovicë Jugore, Pejë, Prishtinë, Ranillug, Shtime, Skenderaj, Vushtrri, Zveçan.

Jo: Dragash, Fushë Kosovë, Gjilan, Hani i Elezit, Istog, Junik, Kaçanik, Kllokot, Malishevë, Mamushë, Mitrovicë Veriore, Novobërdë, Obiliq, Partesh, Podujevë, Prizren, Rahovec, Shtërpçë, Suharekë, Viti, Zubin Potok.

## 2019

Po: Deçan, Dragash, Ferizaj, Fushë Kosovë, Gjakovë, Graçanicë, Istog, Kamenicë, Klinë, Leposaviq, Lipjan, Malishevë, Mamushë, Mitrovicë Veriore, Mitrovicë Jugore, Obiliq, Partesh, Pejë, Prishtinë, Ranillug, Shtime, Skenderaj dhe Vushtrri.

Jo: Gjilan, Glllogoc, Hani i Elezit, Junik, Kaçanik, Kamenicë, Kllokot, Mamushë, Novobërdë, Podujevë, Shtërpçë, Suharekë, Viti, Zubin Potok dhe Zveçan.

**A i ka rishikuar KK politikat, praktikat dhe aktivitetet komunale për të siguruar që të drejtat dhe interesat e komuniteteve po respektohen plotësisht?**

## 2017

Po: Dragash, Ferizaj, Glllogoc, Graçanicë, Lipjan, Malishevë, Mamushë, Mitrovicë Jugore, Obiliq, Partesh, Prishtinë, Prizren, Rahovec, Shtime, Suharekë.

Jo: Deçan, Fushë Kosovë, Gjakovë, Gjilan, Hani i Elezit, Istog, Junik, Kamenicë, Kaçanik, Klinë, Kllokot, Leposaviq, Mitrovicë Veriore, Novobërdë, Pejë, Podujevë, Ranillug, Skenderaj, Viti, Vushtrri, Zubin Potok, Zveçan, Shtërpçë.

## 2019

Po: Dragash, Fushë Kosovë, Glllogoc, Graçanicë, Lipjan, Malishevë, Mamushë,

Mitrovicë Jugore, Obiliq, Prishtinë, Prizren, Rahovec, Shtime, Skenderaj, Shtërpçë, Suharekë dhe Vushtrri.

Jo: Deçan, Ferizaj, Gjakovë, Gjilan, Hani i Elezit, Istog, Junik, Kaçanik, Kamenicë, Klinë, Kllokot, Leposaviq, Mitrovicë Veriore, Novobërdë, Partesh, Pejë, Podujevë, Ranillug, Viti, Zubin Potok dhe Zveçan.

**A është hartuar dhe miratuar plani i punës apo plani i aktiviteteve për ZKKK-në?**

## 2017

Po: Dragash, Ferizaj, Gjilan, Glllogoc, Graçanicë, Istog, Kamenicë, Kaçanik, Kllokot, Lipjan, Novobërdë, Obiliq, Pejë, Podujevë, Prishtinë, Prizren, Rahovec, Ranillug, Shtime, Skenderaj, Shtërpçë, Viti, Vushtrri.

Jo: Deçan, Fushë Kosovë, Gjakovë, Hani i Elezit, Junik, Klinë, Malishevë, Mamushë, Mitrovicë Jugore, Partesh, Suharekë, Zveçan.

## 2019

Po: Deçan, Dragash, Ferizaj, Fushë Kosovë, Gjakovë, Gjilan, Graçanicë, Istog, Junik, Klinë, Lipjan, Mitrovicë Jugore, Novobërdë, Obiliq, Partesh, Pejë, Podujevë, Prishtinë, Prizren, Rahovec, Shtime, Skenderaj, Shtërpçë, Vushtrri.

Jo: Glllogoc, Graçanicë, Hani i Elezit, Kamenicë, Kaçanik, Kllokot, Malishevë, Mamushë, Suharekë, Viti, Zveçan.



**A ka nxjerrë ZKKK raport vjetor me shkrim? Nëse jo, a ka ndonjë plan/angazhim të veçantë për raportimin?**

**2017**

Po: Dragash, Ferizaj, Fushë Kosovë, Gjakovë, Gjilan, Gllogoc, Graçanicë, Istog, Klinë, Kllokot, Lipjan, Malishevë, Mitrovicë Jugore, Novobërdë, Obiliq, Pejë, Podujevë, Prishtinë, Prizren, Rahovec, Ranillug, Shtime, Skenderaj, Shtërpçë, Viti dhe Vushtrri.

Jo: Deçan, Junik, Kaçanik, Kamenicë, Mamushë, Partesh, Suharekë, Viti dhe Zveçan.

**2019**

Po: Deçan, Dragash, Ferizaj, Fushë Kosovë, Gjakovë, Gjilan, Graçanicë, Istog, Kaçanik, Kamenicë, Klinë, Kllokot, Lipjan, Mitrovicë Jugore, Novobërdë, Obiliq, Partesh, Pejë, Podujevë, Prishtinë, Prizren, Rahovec, Ranillug, Shtime, Skenderaj, Shtërpçë dhe Viti.

Jo: Gllogoc, Hani i Elezit, Junik, Malishevë, Mamushë, Suharekë, Vushtrri dhe Zveçan.

**A ka punuar ZKKK-ja për zhvillimin, monitorimin ose vlerësimin e projekteve nga të cilat përfitojnë komunitetet?**

**2017**

Po: Dragash, Fushë Kosovë, Gjakovë, Gjilan, Istog, Klinë, Lipjan, Novobërdë, Obiliq, Podujevë, Prishtinë, Prizren, Shtime, Suharekë, Vushtrri dhe Zveçan.

Jo: Deçan, Ferizaj, Gllogoc, Graçanicë, Hani i Elezit, Junik, Kaçanik, Kamenicë, Kllokot, Malishevë, Mamushë, Mitrovicë Jugore, Partesh, Pejë, Rahovec, Ranillug, Skenderaj, Shtërpçë dhe Viti.

**2019**

Po: Dragash, Fushë Kosovë, Gjakovë, Gjilan, Graçanicë, Istog, Kamenicë, Klinë, Lipjan, Novobërdë, Obiliq, Pejë, Prishtinë, Prizren, Rahovec, Shtime, Shtërpçë dhe Suharekë.

Jo: Deçan, Ferizaj, Gllogoc, Hani i Elezit, Junik, Kaçanik, Kllokot, Malishevë, Mamushë, Mitrovicë Jugore, Partesh, Podujevë, Ranillug, Skenderaj, Viti, Vushtrri dhe Zveçan.

**A i ka dhënë NKK këshilla dhe udhëzime të veçanta kryetarit të komunës për çështje të komunitetit?**

I detyrueshëm

Po: Dragash, Fushë Kosovë, Kllokot, Novobërdë, Prizren dhe Shtërpçë.

Jo: N/A

Jo i detyrueshëm

Po: Ferizaj, Kamenicë, Lipjan, Mamushë, Obiliq, Zubin Potok dhe Zveçan.

Jo: N/A

**A ka siguruar NKK që ekzekutivi komunal (p.sh., ZKKK-ja dhe drejtoritë e tjera komunale) zbaton në mënyrë efektive projekte/ aktivitete/politika/ rregullore në lidhje me mbrojtjen dhe promovimin e të drejtave të komuniteteve?**

I detyrueshëm

Po: Dragash, Fushë Kosovë, Kllokot, Prizren dhe Shtërpçë.

Jo: Novobërdë.

Jo i detyrueshëm

Po: Ferizaj, Kamenicë, Lipjan, Mamushë, Obiliq, Zubin Potok dhe Zveçan.

Jo: N/A

**A e ka promovuar NKK dialogun mes komuniteteve?**

I detyrueshëm

Po: Fushë Kosovë, Kllokot dhe Shtërpçë.

Jo: Novobërdë, Dragash dhe Prizren.

Jo i detyrueshëm

Po: Ferizaj, Kamenicë dhe Lipjan.

Jo: Mamushë, Obiliq, Zubin Potok dhe Zveçan.

**A e takon NKK kryetarin e komunës të paktën çdo muaj për të diskutuar çështje që kanë të bëjnë me komunitetin dhe aktivitetet në vazhdimësi?**

I detyrueshëm

Po: Dragash, Fushë Kosovë, Novobërdë, Prizren dhe Shtërpçë.

Jo: Kllokot.

Jo i detyrueshëm

Po: Ferizaj, Kamenicë, Lipjan, Mamushë, Obiliq, Zubin Potok dhe Zveçan.

Jo: N/A

**A e ka promovuar ZKKKK dialogun mes komuniteteve?**

Po: Kllokot dhe Zveçan.

Jo: Dragash, Graçanicë, Mitrovicë Veriore, Novobërdë, Prizren, Shtërpçë dhe Zubin Potok.

**A i ka trajtuar ZKKKK shqetësimet dhe çështjet që kanë të bëjnë me nevojat e komuniteteve në mbledhjet e kuvendit komunal dhe në punën e tij/saj**

Po: Kllokot, Novobërdë, Shtërpçë, Prizren, Mitrovicë Veriore dhe Zveçan.

Jo: Dragash, Graçanicë dhe Zubin Potok.

**Katalogimi në botim – (CIP)**  
**Biblioteka Kombëtare e Kosovës “Pjetër Bogdani”**

347:316.347.2(496.51)"2021"(047)

Vlerësim i themelimit, funksionalizimit dhe performancës së mekanizmave komunalë të pjesëmarrjes dhe përfaqësimit të komuniteteve / OSBE, Misioni në Kosovë. - Prishtinë : OSBE, Misioni në Kosovë, 2021.- 60 f. : ilustr. ; 30 cm.

**ISBN 978-9951-662-05-5**

